Rahim Dauti

RRUGËTIMI I LIBRIT...

(Ngritja dhe rënia e Panaireve të librit)

Editor
Azam Dauti

Recensentë
Abedin Krosi

Rahim Dauti

RRUGËTIMI I LIBRIT...

(Ngritja dhe rënia e Panaireve të librit)

Botues
Shkupi
Shkup, 2O24

PARATHËNIE

Libri "Rrugëtimi i librit..." *(Ngritja dhe rënia e Panaireve të librit*) i autorit Rahim Dauti nuk është vetëm një përmbledhje ngjarjesh të Panaireve të librit nga viti 2000 - 2004, por është një histori e lavdishme e librit shqip gjatë viteve 2000-ta.

E sidomos nëse këto ngjarje trajtohen nga shumë këndvështrime. Paraqitja e Panairit të parë të librit që u organizua në Tetovë në vitin 2000, përveç jehonës letrare dhe kulturore, pati edhe ndikim shoqëror që ngriti zërin e arsyes për anashkalimin e librit, kulturës dhe arsimit shqip në Maqedoni.

Mjerisht, edhe pas 24 viteve, situata nuk ka ndryshuar shumë në aspektin cilësor, por vetëm në atë sasior.

Gjendja letrare e kulturore...

Situata dhe raportet reale shoqërore në Maqedoni mes dy komuniteteve më të mëdha nuk ishin të mira. Kjo shihet edhe me Kushtetutën e vitit 1991, ku të drejtat e shqiptarëve as në kushter e pluralizmit demokratik nuk shënuan përparim, por u kthyen prapa.

Ekskluziviteti për ta udhëhequr Maqedoninë iu ishte dhënë vetëm komunitetit dhe subjekteve maqedonase, dhe kjo situatë ishte burim i mosmarrëveshjeve dhe pakënaqësive të vazhdueshme.

Edhe pas Marrëveshjes së Ohrit, që avancoi dukshëm të drejtat e shqiptarëve, implementimi i saj nuk i përmbushi

kërkesat reale të shqiptarëve, veçanërisht në kulturë dhe veprimtari botuese.

Politika shqiptare nuk u angazhua seriozisht për të ndaluar anashkalimin kulturor dhe letrar në Maqedoni. Në fakt, në raste të caktuara, kjo politikë e ka shkatërruar edhe më shumë zhvillimin letrar dhe kulturor shqiptar në Maqedoni.

Për shembull, tekstet shkollore në gjuhën shqipe në Maqedoni, edhe pas 24 viteve, jo vetëm që nuk janë përmirësuar, por janë bërë edhe më të pakuptueshme për nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë. Kjo ka ndodhur për shkak të përkthimeve (nga maqedonishtja në shqip) dhe sintaksës së gabuar. Për këtë, politikanët shqiptarë që kanë qeverisur që nga viti 2000 e këndej e mbajnë përgjegjësi, pavarësisht nga ajo, se ata fajin gjithmonë e hudhin diku tjetër, kryesisht në vende të gabuara.

Në këto rrethana, Shtëpia Botuese "Shkupi" nga Shkupi dhe libri shqip kanë kaluar me shumë pengesa dhe barriera, por me një ambicie dhe vullnet të çeliktë për të sjellë sa më shumë botime me vlera të pakontestueshme për lexuesin shqiptar. Edhe pas 30 vitesh ekzistence, nuk mund të thuhet se kemi avancuar shumë në botimet tona, që nga fillimi ynë në vitin 1994. Ndjehemi sikur po lëvizim në vend.

Autori Rahim Dauti në librin e tij flet për një moment të rëndësishëm në fillimet e tranzicionit në vitet '90-ta dhe për vitet 2000-ta. Bëhet fjalë për një kapitull të ri në përhapjen e librit shqip në gjithë hapësirat shqiptare, një rrethanë lehtësuese të interkomunikimit kulturor shqiptar që më parë nuk ekzistonte për shkak të barrierave gjeografike dhe ideopolitike. Liberalizimi i kufijve shtetërorë dhe shpirtërorë midis shqiptarëve, që ishin

vendosur me dekada nga qeveritë moniste, bëri të mundur një komunikim të ri kulturor.

Në këtë periudhë, panairet e librit u shfaqën në të gjitha qendrat administrative dhe kulturore shqiptare, të cilat autori Rahim Dauti i quan "ngjarje fatlume për kulturën shqiptare dhe librin shqip."

Organizimet e para...

Lexuesi i kujdesshëm do të vërejë se si autori, duke marrë pjesë në shumë panaire të librit shqip si koordinator kryesor dhe organizator i ekipit të ShB "Shkupi", sjell atmosferën e atëhershme të këtyre ngjarjeve kulturore. Për shembull, autori përkujton (por për shkak të mungesave fotografike nuk e përshkruan) Panairin e Librit në Prishtinë të vitit 1999, që u mbajt vetëm disa muaj pas çlirimit të Kosovës nga okupatori serb, si një ngjarje madhështore për Kosovën dhe botën shqiptare.

Lexuesi i këtij ibri, posa ta lexojë veprën "Rrugëtimi i librit…" (Ngritja dhe rënia e Panaireve të librit) të Rahim Dautit, do të vërejë qartë se si autori, duke marrë pjesë në shumë panaire të librit shqip, si koordinator kryesor dhe organizator i ekipit të ShB "Shkupi", na sjell atmosferën e atëhershme tejet të këndshme, të këtyre ngjarjeve kulturore, që më parë nuk i kishim pasur. Për shembull, autori në libër, duke qenë pjesëmarrës në Panairin e librit të Prishtinës të vitit 1999 do të thotë: Në Panairin e librit në Prishtinë, që u mbajt vetëm disa muaj pas çlirimit të Kosovës nga okupatori serb, "erdhën gjithë ato personalitete që kishin peshë – shkrimtarë, botues, por edhe kreatorë të jetës politike të shoqërisë shqiptare".

Ndërkaq, autori panairin e parë të librit të pasluftës, atë të vitit 1999 në Prishtinë, me të drejtë e radhitë si ngjarje madhështore, jo vetëm për Kosovën e lirë, por edhe për tërë botën shqiptare. Këtu, atëherë, morën pjesë dr. Ibrahim Rugova, udhëheqës i shtetit më të ri në Evropë dhe botë, Ismail Kadare, akad. Rexhep Qosja, shkrimtari dhe veprimtari Adem Demaçi, Thoma Kacorri, e si mysafir i SHB "Shkupi" edhe Sami Krosi dhe shumë të tjerë.

Duhet theksuar se autori në libër flet dhe shkruan për shumë panaire të tjerë, sjell përshkrime interesante dhe momente shumë të rëndësishme kulturore nga panairet në Tetovë 2000, në Tiranë - 2001, në Shkup – 2002 dhe të tjerë. Për të gjitha këto ngjarje të rëndësishme kulturore, autori ka bërë përpjekje maksimale, duke shprehur kujdes dhe dashuri të veçantë në prezantimin objektiv dhe autentik të aktiviteteve të lloj-llojshme të tërë mozaikut letrar, artistik e kulturor, që zhvillohej në të gjitha panairet e librit shqip.

Përtej afirmimit të librit...

Gjithashtu, më duhet të vlerësoj se mënyra e të rrëfyerit, me përshkrimet interesante në një tekst të thurur bukur nga aktivitetet përcjellëse të manifestimeve në fjalë, flet për një dimension kreativ, estetik e artistik të theksuar, që e përshkon çdo faqe të librit. Veçmas dallohen takimet me personalitete të ndryshme, dialogjet e gjalla dhe vrojtimet e tij personale për shumë detaje interesante. Nuk haset shpesh një botim me përmbajtje të këtillë që të përfshijë kaq shumë ngjarje që t'ia prezantojë lexuesit nëpërmjet gjinisë së reportazhit, që si gjuhë, stil po sillet ndërmjet shprehjes gazetareske – publicistike dhe asaj letrare, duke anuar nga e para për shkak të përmbajtjes.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto dhe sidomos për shkak se dashamirëve të librit u ofron shumë përshkrime të përmbledhura për më shumë panaire, dhe në këtë kontekst edhe disa përmbajtje plotësuese, e pashë të arsyeshme që veprën "Rrugëtimi i librit..." (Ngritja dhe rënia e Panaireve të librit), me disa modifikime ta ribotojmë në këtë formë! Këtë, po e bëjmë, për shkak se me shembjen e kufijve shpirtërorë midis shqiptarëve, që ishin vendosur si rezultat i atyre kufijve administrativë, u shfaq një fenomen i ri komunikimi, madje dhe një nevojë e madhe që e imponoi koha. Lindën panairet e librit, që dikur nuk i kishim. Ato lindën si ngjarje që gjallëruan jetën kulturore të shqiptarëve të shpërndarë pikë e pesë nëpër Ballkan. Atë vit, pra, më 1999, libri shqip u gjet në një vend dhe erdhi nga të gjitha trojet shqiptare. Iu afrua lexuesit më tepër se kurrë më parë.

Panairet e librit: Ura ndërkulturore

Panairet e librit në hapësirat shqiptare kanë shërbyer si një urë ndërkulturore, duke lidhur komunitete dhe duke ndihmuar në shkëmbimin e ideve dhe kulturave. Këto ngjarje kanë krijuar një platformë ku shkrimtarët, botuesit dhe lexuesit mund të ndërveprojnë, të ndajnë përvojat e tyre dhe të promovojnë vlerat e përbashkëta kulturore. Një shembull i shkëlqyer është panairi i librit në Shkup në vitin 2002, ku morën pjesë botues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, duke sjellë një shumëllojshmëri të librave dhe ideve. Ku në këtë Panair libri, përveç librit shqip, u paraqitë edhe libri maqedonas, turk etj.

Panairet si nxitës të zhvillimit kulturor

Panairet e librit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin kulturor të komuniteteve shqiptare në hapësirat shqiptare. Ato kanë ndihmuar në promovimin e literaturës shqiptare dhe në inkurajimin e leximit.

Nëpërmjet këtyre ngjarjeve, lexuesit kanë pasur mundësinë të takohen me autorët e tyre të preferuar, të marrin pjesë në diskutime dhe të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore. Panairi i librit në Tiranë në vitin 2001 është një shembull i shkëlqyer i kësaj dinamike, ku lexuesit nga të gjitha moshat u mblodhën për të festuar librin dhe kulturën shqiptare.

Një traditë në rritje...

Me kalimin e viteve, panairet e librit janë bërë një traditë e rëndësishme në hapësirat shqiptare. Çdo vit, në qytete të ndryshme, këto ngjarje tërheqin mijëra vizitorë dhe ofrojnë një platformë për promovimin e literaturës dhe kulturës shqiptare. Panairet në Ulqin, Preshevë dhe Bujanoc kanë treguar se ka një interes të madh për librin shqip dhe për kulturën shqiptare edhe në këto zona, ku komuniteti shqipatar nuk është i madh. Këto ngjarje kanë ndihmuar në krijimin e një rrjeti të fortë të botuesve dhe autorëve, duke përmirësuar cilësinë dhe qasjen në libra për të gjithë lexuesit.

Sfida dhe përparime

Organizimi i panaireve të librit nuk ka qenë gjithmonë i lehtë. Ka pasur sfida të shumta, duke përfshirë kufizimet financiare, pengesat administrative dhe mungesën e mbështetjes institucionale.

Megjithatë, përkushtimi dhe vullneti i botuesve dhe autorëve kanë bërë të mundur që këto ngjarje të vazhdojnë dhe të përparojnë. Për shembull, panairi i librit në Tetovë në vitin 2000 u përball me shumë sfida, por përpjekjet e organizatorëve dhe mbështetja e komunitetit e bënë atë një sukses të madh. Në atë kohë edhe stendat mungonin, prandaj u detyruam t'i huazonim nga Panairi i librit të Prishtinës.

Gjatë panaireve të tjerë, gjithmonë ka pasur edhe pengesa administrative nëpër dogana, shkaku se libri vazhdon të jetë i doganueshëm, ndërkaq organizatorët e Panairit të librave në Shkup e Tetovë, nuk kishin fuqi politike, që këtë ta bëjnë padoganueshëm. Përkundër nismave të shumta për qarkullimin e lirë të librit në Ballkan, mjerisht libri edhe sot e kësaj dite mbetet "mall i doganueshëm", si çdo mall tjetër.

Prandaj, që librat të hynin me kamiona në Maqedoni, duheshin edhe lidhjet miqësore dhe të mirëkuptueshme, që këto libra të rrugëtonin drejt këtyre panaireve tona të librit. Kjo, ishte një ndër mbështetjet e pakta nga politika shqiptare në Maqedoni, e cila ndonjëherë edhe nuk funksiononte, por duhej shfrytëzuar agjencitë e shpedicioneve, që këto libra nga Shqipëria dhe Kosova të arrinin deri tek këto dy Panaire tonat në Maqedoni!

Rëndësia e mbështetjes institucionale

Mbështetja institucionale ka luajtur një rol të rëndësishëm në suksesin e panaireve të librit. Bashkëpunimi me qeveritë lokale dhe organizatat kulturore ka ndihmuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e këtyre ngjarjeve. Për shembull, mbështetja e qeverisë së Kosovës në organizimin e panairit të librit në Prishtinë ka qenë thelbësore për suksesin e tij. Institucionet kulturore kanë ofruar mbështetje logjistike dhe diku – diku edhe financiare, duke ndihmuar në promovimin e librave dhe autorëve shqiptarë. Edhe pse, në organizimin e Panairev të librit në Tetovë dhe Shkup, kjo nuk ka ndodhur, pothuajse asnjëherë, megjithatë në Kosovë dhe Shqipëri, këto institucione dhe madje edhe tregtare private, kanë zgjatur dorën edhe për organizime të këtilla, që e afirmojnë librin shqip.

Panairet dhe edukimi

Panairet e librit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në edukimin e publikut dhe në promovimin e leximit si një aktivitet i vlefshëm dhe i rëndësishëm. Shumë panaire kanë ofruar programe edukative dhe aktivitete për fëmijët dhe të rinjtë, duke inkurajuar ata të lexojnë dhe të zhvillojnë dashurinë për librat. Panairi i librit në Prishtinë, Tiranë, por edhe ai në Tetovë dhe Shkup, kanë organizuar aktivitete të shumta edukative, duke përfshirë leximet e librave për fëmijët, diskutimet me autorët dhe punëtoritë krijuese.

Në të gjitha panairet e librave, në mënyrë të organizuar nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme kanë qenë vizitorët më besnik të këtyre ngjarjeve letrare.

E ardhmja e Panaireve të librit

E ardhmja e panaireve të librit duket premtuese, pavarësisht nga ajo, që panairet e librave gjithkund në botë, kanë filluar të zbehen. Kjo, ka ndodhur për shumë arsye, por një nga kryesoret është se nga pandemia e kovidit e këndej, sikur ka një shkëputje nga manifestimet e këtilla letrare. Prandaj, me përparimin e teknologjisë dhe rritjen e qasjes në informacion, këto ngjarje kanë potencialin të arrijnë një audiencë më të gjerë dhe të promovojnë librin shqip në mënyra të reja dhe inovative. Panairet virtuale dhe platformat online mund të ndihmojnë në zgjerimin e ndikimit të këtyre ngjarjeve, duke bërë të mundur që lexuesit nga të gjitha pjesët e botës të marrin pjesë dhe të përfitojnë nga oferta e librave shqiptarë.

Përfundim

Libri "Rrugëtimi i librit..." është një dokument i rëndësishëm që përshkruan historinë e librave dhe panaireve të librit në hapësirat shqiptare. Ai na kujton rëndësinë e këtyre ngjarjeve për kulturën dhe identitetin tonë kombëtar. Me përkushtimin dhe përpjekjet e vazhdueshme të botuesve, autorëve dhe mbështetësve të kulturës, panairet e librit do të vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e literaturës shqiptare dhe në zhvillimin e një komuniteti të fortë dhe të bashkuar letrar.

Botuesi

PANAIRI I LIBRIT "TETOVA 2000"
(1-5 tetor 2000, Pallati i Kulturës në Tetovë)

Më në fund edhe në Maqedoni do të lindë një panair i librit shqip – "...Tetova 2000". Qyteti rrëzë Sharrit, i njohur vite me radhë për shumë aktivitete kulturore dhe të tjera, si festivali i folklorit "Sharri këndon", manifestimi poetik "Ditët e Naimit", zgjedhja e sportistit më të mirë shqiptar në Maqedoni etj., do të pasurohet edhe me festën e librit: "Panairi i librit Tetova 2000". Organizator: Shoqata e Botuesve Shqiptarë, me mbështetje materiale edhe nga Komuna e Tetovës dhe Pallati i Kulturës në Tetovë.

Nga e majta:

Azam Dauti (kryetar i ShBSh-së), Xhemil Selimi, Fatmir Toçi (kryetar i LBSh-së), Sevim Ahmeti, Xhevat Syla (Libri shkollor, Prishtinë), Qamil Rufati, Abdylmexhit Saliu, Faik Selimi, Nazmi Rahmani (kryetar i ShBK-së), Zulqifli Sulejmani (drejtor i Pallatit të Kulturës në Tetovë, që me një entuziazëm shembullor dha kontributin e tij të madh në mbarëvajtjen e panairit të librit) dhe Halil Zendeli.

Kështu, në Tetovë u tubuan shumica e shtëpive botuese nga të gjitha trojet shqiptare. Këtë ngjarje të madhe kulturore me peshë edhe historike, do ta përcjellin të gjitha mediumet e rëndësishme shqiptare dhe ato maqedonase.

Para hapjes së Panairit para shtëpisë së kulturës, janë mbledhur një numër i madh i qytetarëve nga të gjitha qytetet shqiptare, si dhe nga Tirana dhe Prishtina, për të bërë respektin e merituar. Panairin do ta shpallë solemnisht shkrimtari i shquar nga treva e Tetovës, Abdylazis Islami, i cili dukshëm i lodhur nga mosha e shtyrë, do të thotë ca fjalë rasti.

Kështu, ai shprehu gëzimin e vet se më në fund ëndrra për një manifestim të tillë u realizua, dhe se libri më në fund arriti t'i fshijë ata kufij administrativë, që të kalojë lirë dhe të bashkojë shpirtin e shqiptarit, kudo që të gjendet ai. Duhet përmendur se aty u gjetën edhe personalitete që dhanë kontribut të pamohueshëm në letrat shqipe, si akademik Rexhep Qosja, dr. Agim Vinca, rektori i Universitetit të Tetovës, Fadil Sulejmani etj., si dhe njerëz të tjerë të kulturës, por edhe të politikës. Duke e përshëndetur këtë manifestim, kryetarët e Asociacioneve botuese nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia thanë se "ëndrra shekullore që të shlyhen kufijtë" atë ditë edhe "u realizua". Atë që nuk arritën ta bëjnë politikanët e bëri libri, duke i bashkuar shqiptarët në një qytet me "përcaktim kulturor".

Tashmë, filloi ky manifestim i madh, duke ardhur për t'ua uruar secilit botues nga të gjitha personalitetet e shquara shqiptare që ndodhën në këtë manifestim. Akademik Rexhep Qosja, duke shëtitur nëpër stendat e botuesve u ndal tek stenda e SHB "Shkupi" me urimin dhe me dëshirën e tij për sukses të panairit, duke shprehur interesim për veprimtarinë e kësaj shtëpie botuese. Menjëherë i bie në sy libri "Shqiptarët e Ukrainës" të autorëve Daut Dauti dhe Sefer Musliu, dhe me këtë rast ai na tha: "Ju lumtë, që e keni botuar këtë libër unikat, sepse keni bërë një punë të madhe për shkëputjen e një pjese

shqiptare që nga koha e Skënderbeut, që janë dëbuar nga Perandoria Osmane, e gjetën strehim në Ukrainë". Kështu, duke ia dhuruar këtë libër, renditen njerëzit duke uruar hapjen e Panairit edhe në stendën e kësaj shtëpie botuese. Për ne si pjesë e organizatorëve, ishte një befasi e rrallë, që qysh në panairin e parë të shohim aq shumë të interesuar për librin shqip. Në këtë atmosferë gëzimi, vërshuan si lum miq e dashamirë të njohur nëpër të gjitha stendat e botuesve shqiptarë, ndërkaq në stendën tonë, më shumë jepnim libra gratis se sa me para. Kuptohet interesimi për librin ishte i madh edhe nga të gjitha shtresat e popullatës, si fshatarë, nxënës, studentë, qytetarë etj., e që të gjithë kishin një gjë të përbashkët "si e si të vinin deri tek libri, i cili as vjetrohet e as vdes kurrë".

Në stendën tonë vinin edhe disidentë shqiptarë, ndër ta më la përshtypje sidomos një ish i diferencuar politik dhe i dëbuar nga puna, që ishte larguar para 10 viteve nga Tetova, e që emri i tij nuk më kujtohet por ia mbajta mend nofkën DAJA, që jetonte e punonte në Suedi. Duke ardhur tek stenda do ta vërej titullin e librit "Nata në ekzil" të autorit të ndjerë Sabri Zirap Dauti-SAZIDA, do të këmbejmë disa fjalë për ekzilin, dhe më tregon kronologjinë e ikjes së tij në Suedi. Derisa kuvendonim te stenda, ia porosita një kafe këtij njeriu të përvuajtur dhe një lëng molle për veti. Kur na i solli kamerieri, Daja, i ulur pranë librave dhe në atë moment tha: "O zot, arrita në jetën time, të gëzohem e të ndjehem i lumtur duke pirë kafe mbi libra. Nuk kam përjetuar kënaqësi e gëzim më të madh në jetë se sa të pijë kafe pranë librave". Dhe ai vazhdon: "Për shkak të librit shqip më kanë diferencuar dhe, ja, erdhi kjo ditë e lumtur që libri të marrë frymë lirshëm pa kufizime e barriera".



Mendoj që kjo ngjarje ishte ajo bindja se edhe ne shqiptarët mundemi të organizohemi dhe dimë t'i mbajmë vetë nën kontroll të gjitha aktivitetet tona kombëtare. Si rezultat i këtij organizimi të mirëfilltë ne dëshmuam aftësitë tona organizative dhe vetëdijen e ngritur të botuesve dhe njerëzve, të librit dhe kulturës tek shqiptarët e Maqedonisë. Po pa politizim edhe pa kushtëzime, kështu numri i vizitorëve rritej çdo ditë e më tepër, kështu kishte mendime që Panairi i librit Tetova 2000 të zgjatej edhe për katër ditë të tjera, por kjo nuk ishte e mundshme për shkaqe teknike. Ishte një punë e madhe që vetë botuesit u njoftuan ndërmjet veti dhe u bënë miq, e kjo miqësi do të fillojë të bëhet një varësi e ndërsjellë që do t'i përcjellë në të gjitha panairet tjera në tërë hapësirën shqiptare.

Pa marrë parasysh se konkurrenca krijon edhe xhelozi profesionale, ne botuesit ato dukuri i kanalizojmë në mënyrë që të përmirësohet cilësia e librit, modernizimi i disenjit si dhe të bëhet përgatitja e librit sa më cilësor, që do të bëjë për vete sa më shumë lexues. Pra, duke i marrë përvojat e njëri tjetrit edhe do të lindin mendime të ndryshme për përgatitjen, botimin si dhe distribuimin e librit. Poashtu, marketingut, që është një fushë e rëndësishme për popullarizimin e librit, të gjithë ngapak do t'i kushtojmë vëmendje, që sa më shumë të shpërndahen librat. Këtu, ne filluam të mësojmë ato gjëra që deri atëherë i kemi bërë shkel e shko dhe jo me ndonjë profesionalizëm të veçantë. Në fund doli vlerësimi se kjo ngjarje e rëndësishme u bë me sukses dhe në panair pati diku afër 60 mijë vizitorë dhe se si rezultat i këtij masiviteti, janë shitur mbi 50 mijë ekzemplarë që do të thotë që gjatë një gjysme shekulli të kaluar nuk kanë ardhur aq shumë libra tek lexuesit. Ky argument ishte i mjaftueshëm që Panairi Tetova 2000 ta arsyetojë vetveten dhe të përfundjë i suksesshëm. Pra, këto indikacione ishin të mjaftueshme për vazhdimin e traditës edhe në vitet e ardhshme.

Kuptohet që çdo panair përcillet edhe me promovime të librave, në këtë frymë edhe shtëpia jonë botuese SHKUPI, organizoi një promovim simpatik para stendave të veta të autorit Thoma Kacori "Ndriçime". Me këtë rast "rilindësi i fundit shqiptar", siç e quajnë Thoma Kacorin, duke shprehur gëzimin e tij për respektin që i bëjnë lexuesit e këtushëm, do të shprehet: "Për mua mjafton që jam gjallë e shëndoshë në mesin e vëllezërve dhe motrave shqiptare rrëzë Sharrit".

Një karakteristikë pozitive e këtij panairi ishte edhe këmbimi i librave ndërmjet botuesve shqiptarë. Duke u përshëndetur mes veti mbeti betimi, që do të takohen në panairin e ardhshëm në Tiranë dhe nëpër panaire të tjera me po aq mall dhe gëzim sa në Tetovë.

Në fund pasi të bëhet rrumbullakimi i përshtypjeve, fillojnë vlerësimet se a thua ka mundur të jetë organizimi më i mirë, a mos vallë kemi bërë ndonjë lëshim, mos kemi harruar ndonjë libër të ri pa promovuar...Kuptohet që kritikat e mira në shtyp e media e gëzojnë pa masë çdo botues, si prindi kur ia blenë ndonjë lojë për ta gëzuar fëmijën e vet.

Dhe gjithmonë pas përfundimit, do të mbeten shumë kujtime të mira dhe momente që nuk fshihen nga kujtesa. Natyrisht se këto kujtime do të na disponojnë, që t'i harrojmë lodhjet dhe tempin dinamik të aktiviteteve brenda panairit.

Nga e majta:
Shkrimtari Sami Krosi, autori i librit dhe Genti (librar nga Tirana) në Panairin e librit "Tirana 2001"

PANAIRI I LIBRIT "TIRANA 2001"

(7-12 nëntor 2001, në Pallatin e Kulturës "Piramida" në Tiranë)

Na arrin ftesa për pjesëmarrje në panairin e librit Tirana 2001. Nuk ka si të refuzohet një mundësi e tillë, për çka normalisht, i bëjmë përgatitjet për të shkuar. Në fillim, kuptohet që i përgatisnim librat, i bëjmë ekipet për udhëtim, sigurojmë një autorizim zyrtar, caktojmë udhëheqës të grupit...

Si udhëheqës i grupit caktohet të jetë autori i këtij libri. Në të marrin pjesë shtëpitë botuese "Shkupi", "Flaka",

"Asdreni", "Vatra", "Furkan-Ism", të gjitha nga Shkupi. Në këtë "shoqëri" është edhe Biblioteka e Qytetit nga Tetova, pjesëmarrjen e së cilës disa nga botuesit e shikojnë me dyshim, pasi pyesin se çka mund të shesë biblioteka? Ndoshta librat që ia kanë dhuruar botuesit gjatë vitit të kaluar, thotë njëri, i cili haptas dyshon në matrapazllëkun e drejtorit të saj. Sepse, nuk është praktikë e njohur që të marrin pjesë bibliotekat me stenda shitëse.

Kështu, një ditë para hapjes së panairit, nisemi në mbrëmje me autobusin i cili qarkullon në relacionin Shkup-Tiranë, dhe anasjelltas. Më duhet të përmend se në shoqëri me grupin tonë do të jetë edhe Sami Krosi, autori i disa librave të botuar në shtëpinë botuese "Shkupi". Udhëtojmë me autobusin "Mercedes" të Ndërmarrjes Transportuese "POLLOG" nga Tetova, me dy vozitësit profesionalë. Është kohë jo e përshtatshme për udhëtime, sidomos natën.

Vetëm disa muaj kanë kaluar nga përmbyllja e konfliktit, dhe ende nuk janë hequr tërësisht punktet policore.

Kështu në një punkt policor, do ta ndalin autobusin me ç'rast policia do të bëjë një kontroll jo edhe aq të thjeshtë, sepse gjatë kontrollit të udhëtarëve, policët kishin një listë të personave të dyshimtë, sigurisht të atyre që kishin marrë pjesë në luftë. Askush nga ne nuk kishte pandehur se ndër të "dyshimtët" do të gjendet edhe shkrimtari Sami Krosi, bashkë me disa të tjerë që i zbritën nga autobusi. Si duket, policisë i kishte bërë përshtypje mbiemri Krosi dhe ndoshta do të kishin ndonjë person në listë me mbiemër të tillë. Por, meqë nuk përkonte edhe emri në pasaportë, e as mosha e z.Samiut që kishte kaluar të 60-tat, policia e lejon autobusin të vazhdojë rrugën. Pas përafërsisht tri orësh, arritëm në pikën kufitare të Qafë Thanës. Pason edhe një kontroll i rregullt i pasaportave e si zakonisht edhe kontrollimi i

ndonjë malli të tepërt, por edhe të ndonjë udhëtari që nuk i ka dokumentet valide. Në autobus janë edhe disa rumunë të cilët duan që nëpërmjet Shqipërisë të kalojnë në Itali, e të vazhdojnë rrugën e vet drejtë perëndimit, mbase me te vetmin qëllim për të gjetur punë e për të siguruar ekzistencën. Këta udhëtarë i zbret policia nga autobusi, për çka pritëm më shumë se një orë. Më në fund, edhe ata kthehen në vendet e veta në autobus dhe kjo është shenjë se ata i paskan pasur në rregull dokumentet e veta. Tash i vjen radha doganierit, i cili e bën poashtu punën e vet, me pyetjen se a mos vallë ka dikush të lajmërojë ndonjë mall për t'u doganuar. Menjëherë doganierit i bien në sy paketat me librat, që i kishim për panairin e librit. I thërriti "pronarët" e tyre të zbresin poshtë, ndërsa te unë ishte autorizimi i SHBSH-së. Zbritëm të gjithë librarët poshtë. Me të kuptuar doganieri se ne ishim të ftuar në Panairin e librit në Tiranë, na pyeti se a do t'i kthejmë që t'na i regjistrojnë. Unë, si udhëheqës i botuesve, i tregoj se nuk ka nevojë për diçka të tillë, sepse librat që do të ekspozohen atje nuk e kemi ndërmend që t'i kthejmë. Pas këtij sqarimi doganieri me të vërtetë tregoi mirëkuptim dhe menjëherë u pajtua, duke thëne se atëherë nuk do ketë nevojë që t'na i evidentojë. Kështu e vazhdojmë rrugën deri te dogana tjetër, te dogana e Shqipërisë, edhe aty duhet përsëritur e njëjta procedurë por më e shkurtuar. Mirëpo doganieri shqiptar kishte tjetër mënyrë të komunikimit, kurse unë me të njëjtin shabllon desha ta kaloj doganën mirëpo nuk ndejti pa e kthyer përgjigjen: Zotërinj të nderuar, ne e dimë se çka do të thotë panairi, pra aty është vendi ku shiten librat e se nuk jepen gratis, por unë kam respekt për ju që vini nga Maqedonia, prandaj edhe mund të vazhdoni rrugën dhe ju dëshiroj punë të mbarë dhe sukses e të keni sa më shumë vizitorë e lexues.

Dhe niset autobusi drejt Librazhdit, dhe si zakonisht kur kalon ajo procedura e kalimit kufitar-oganor, dikush nga udhëtarët e nisë ndonjë temë bisede që mund të jetë aktuale. Ato ditë posa kishte ndodhur tmerri në Nju-Jork me rrëzimin e dy kullave binjake më 11 shtator, ku gjetën vdekjen mijëra njerëz. Dikush fliste për kullat, dikush flente, sepse kishte kaluar mesnata, dikush në ndonjë kënd tjetër bisedonte ulur të mos dëgjonte tjetërkush. Autobusi ndonjëherë të ngjan si një treg - ke njerëz të të gjitha kategorive. Më kujtohet se një haxhi plak, i cili me vetëdije apo pa vetëdije, do të mundohet t'i dalë ne mbrojte asaj që as s'e di se kush është e çka don ai, çka përfaqëson e as që e ka dëgjuar ndonjëherë...Duke dashur që të tregojë diçka, haxhiu në mënyrë laike do t'ia rrëfejë një shqiptarit nga Shqipëria atë përrallën e ujkut dhe të farkëtarit. Kur ujku kishte rënë në qytet një ditë pazari, të gjithë kishin vrapuar pas ty katundarët që u kishte bërë dëm, kujt ia kishte ngrënë dhentë, kujt lopën, kujt gomarin ose kalin. Por, kur e sheh se pas tij vrapon edhe farkëtari, dhe kur ky i afrohet, ujku kthehet nga ai i habitur dhe i thotë: I kuptoj këta të tjerët që vrapojnë pas meje, sepse vërtet u kam bërë dëm, po çka ke ti me mua, mos ta kam ngrënë tezjahun?" Pasi haxhiu përfundon përrallën, pasagjeri nga Shqipëria do të reagojë aq ashpër sa që edhe do ta ofendojë haxhiun. "O haxhi, mos u mundo ta mbrosh atë, i cili ka bërë krime, e që ka marrë në qafë njerëz krejtësisht të pafajshëm që fare nuk kanë lidhje me politikën, se ai që vret gra, fëmijë e pleq, nuk mund të jetë as besimtar e as mysliman, prandaj o i nderuar, mos hyn në lojën e tjetër kujt sepse, ne e kemi lojën tonë që akoma s'ka mbaruar e që patjetër duhet të luhet deri në fund. Bile, do të ishte më mirë që ju mjekrën ta rregulloni më të vogël që të mos i përngjajë asaj të Bin

Ladenit", i tha haxhiut nga Maqedonia, i cili me gjasë kishte dashur të arsyetojë aktin terrorist në Nju-Jork.

Në drejtim të Tiranës, gjithmonë e më ngadalë po e kalojmë çdo pjesë të rrugës. Kështu afër Librazhdit, një pjesë e saj fare nuk është e asfaltuar, dhe ata që kanë menduar se do të mund të çlodhen duke u prehur në gjumë, tash u zgjuan nga gungat e papritura në rrugë. Kur arritëm në Elbasan, edhe në të rrugët ishin me gropa dhe të dëmtuara. Tash dy vozitësit mes vete konsultohen se rruga diku është e ndërprerë dhe se patjetër duhet të shkohet nga ana e majtë e saj, në dalje të Elbasanit, prandaj rruga do të zgjasë për 7O km., do të thotë do të shkojmë në magjistralen e re nga Durrësi e jo nga Qafa e Krrabës që është më e shkurtër. Sa i përket kohëzgjatjes së udhëtimit, nuk do to humbim kohë dhe ndoshta nja njëzetë minuta më parë se sa të shkojmë nga ana tjetër. Agimi na gjeti në Durrës, kurse në Tiranë arritëm diku rreth orës gjashtë e dhjetë. Atje duhej të na priste një mik nga Tirana, mirëpo, ai po vonohej dhe erdhi të na kërkojë mbas tridhjetë minutash. Në këtë vakum kohor prej gjysmë ore, do të na afrohen shumë njerëz duke na ofruar lloj-lloj shërbimesh, si p.sh. "A doni taksi?", "A u nevojitet dhomë për fjetje?", "Ku do të shkoni?" e kështu me radhë. Mirëpo, ne s'e kishim mendjen te këto oferta të bezdisshme, sepse na shqetësonte mungesa e personit që duhej të na priste, ndonëse nuk kishim nevojë që të ngutemi, sepse kishim kohë me bollëk. Hapja solemne e panairit ishte paraparë diku kah ora 16 e 30 minuta në muzeun historik, më saktë te "Piramida", që ishte ndërtuar në kohën e monizmit.

Dikur erdhi një njeri thatim hipur në një biçikletë, dhe fare pa e pyetur, na njohu dhe kërkoi falje pse ishte vonuar, duke e arsyetuar se gjithmonë autobusi vjen në ora 6 e 40 minuta që do të thotë, se në atë relacion më të gjatë, kemi

arritur më shpejt për afërsisht 20 minuta për shkak të rrugës më të mirë. Ai na merr te shtëpia e vet, ku do të pushojmë gjer në orët e pasditës. Kah ora tre pas dite, kur u çlodhëm dhe u këndellëm, hëngrëm drekë dhe e morëm një taksi për t'i marrë librat e për t'i dërguar te Piramida, ku do ta gjejë secili botues stendën e vet, të shënuar me emër që para se të arrinim ne. E gjetëm edhe stendën tonë. Erdhi edhe momenti i hapjes solemne ku do të vijë edhe kryetari i Shqipërisë, Rexhep Meidani, Ministri i Rinisë dhe Sporteve, Luan Rama, kryetari i SHBSH-së Fatmir Toçi e shumë mysafirë të tjerë të ftuar enkas nga të gjitha trojet shqiptare, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi. Hapjen solemne e përcjellin shumë kamera televizive, nga RTSH, RTK, e shumë media tjera të shkruara dhe elektronike, shtetërore e të pavarura.

Panairin e librit 2001 do ta shpallë të hapur vetë kryetari i Shqipërisë, Rexhep Meidani, duke thënë, ndër të tjera, se ndjen kënaqësi të veçantë se në një vend janë mbledhur botuesit shqiptarë të gjitha trojeve etnike dhe se kjo është festë e vërtetë për mbarë kombin dhe për të personalisht.

Kryetarin e Shqipërisë, i cili i viziton stendat, e shoqëron kryetari i SHBSH-së, Fatmir Toçi. Vjen edhe në stendën tonë ku na përshëndet përzemërsisht dhe na dëshiroi mirëseardhje. F. Toçi do të na prezantojë se SHB "Shkupi" është një ndër më të parat që ekziston si shtëpi botuese private në gjithë trojet shqiptare dhe se këta gjithmonë na përcjellin dhe nuk na lënë asnjëherë vetëm kudo që të mbajmë panaire. Ndërsa Rexhep Meidani, duke shprehur gëzimin e vet, do të shprehë interesim të madh për punën dhe problemet që ne i kemi rreth botimeve si dhe do të interesohet edhe për gjendjen e shqiptarëve në Maqedoni. Në atë kohëzgjatje të njoftimit, ai do ta vërejë librin "Shqiptarët e Ukrainës" duke dashur që ta blejë.

Kuptohet se ne nuk i morëm para, por ia dhuruam atë libër dhe për mua ishte kënaqësi e vërtetë t'i jepja një botim që ta kishte kujtim nga SHB "Shkupi". Mirëpo, kryetari Mejdani nuk dëshironte ta marrë librin pa e nënshkruar prej përfaqësuesit e kësaj shtëpie botuese. Nënshkrimin e bëra me gëzim dhe ishte nder i madh për mua personalisht. Pastaj u fotografuam dhe shkëmbyem disa mendime lidhur me librin "Shqiptarët e Ukrainës", i cili libër do zgjojë interesim dhe publicitet të madh edhe në ditët tjera. Shumë lexues treguan interesim të veçantë për këtë libër dhe kishin dëshirë që ta kishin në bibliotekën e tyre, prandaj edhe nuk pyesnin për çmimin.

Filloi interesimi për shtëpitë botuese nga Maqedonia, për shkak se një gjë e tillë më parë nuk kishte ndodhur, sikurse që ishte edhe nga kolegu i SHB "Furkan", i cili ishte afër meje, dhe si edhe "Asdreni" e "Vatra", por edhe shtëpia botuese më e vjetër nga Shkupi, "Flaka". Më duhet të përmend se nga Mali i Zi me botimet e tyre merrte pjesë Grupi Letrar Shqiptar, i përfaqësuar nga studjuesi Nail Draga.

Në këtë panair do të kemi mundësi që të njihemi me shumë botues dhe librarë. Njëri ndër ta është edhe autori dhe botuesi i abetares "Udha e Shkronjave", Artur Shkurti, i cili do të shprehë interesimin e vet për distribuimin e kësaj vepre edhe në Maqedoni, bile dhe për të shqyrtuar mundësinë që të hyjë edhe në plan -programet mësimore. Ai më rrëfen se si ka formuar paralele të para private që mësojnë me këtë abetare – "Udha e Shkronjave".

Kjo ishte dita e parë në këtë panair dhe të gjithë pritnim që të vijë ora 20 e 30 minuta, kur organizatorët do të vijnë dhe do të na thonë se orari i punës për ditën e parë ka mbaruar. Unë bashkë me z.Sami Krosin do ta lëshojmë

panairin, kurse nga organizatorët mësuam se nesër panairi i hap dyert në ora 9.

Meqë fjetjen e kemi të siguruar, bëjmë një sheti nëpër qendër të Tiranës, dhe pastaj ulemi te një restorant për të darkuar. Ishte një gjellëtore me meny të larmishme. Pasi ndezëm nga një cigare erdhi kamerieri dhe na e ofroi menynë e ushqimeve. Ai do të vërejë për një çast se ne jemi mysafirë dhe pyetjes se a mos jeni nga Kosova, iu përgjigjëm jo, duke i treguar se jemi nga Maqedonia, konkretisht, nga Shkupi. Ai atëherë do të tregojë se edhe ai ishte nga ish -Jugosllavia, konkretisht nga Ulqini, bile edhe restoranti e kishte emrin e njëjtë, "Ulqini". Duke u marrë vesh se çka do të marrim për darkë, unë porosita gullash. Ai për një çast habitet, pasi nuk e kishte kuptuar përgjigjen, prandaj përsëriti edhe një herë pyetjen se çka duam të hamë. Unë prapë përgjigjem njësoj dhe ai tash pyet habitshëm se çka është ky farë gullashi. Mirëpo, pronari i restorantit, i cili kishte dëgjuar këtë dialog, i sqaron kamerierit se ne po kërkonim atë që ata i thonë "tasqebap". Mirëpo, kjo fjalë ishte e re për ne që vinim për herë të parë në Shqipëri. A thua ky "tasqebapi" është gullashi "ynë"? Derisa prisnim në heshtje se çka do të dalë nga kjo shpërputhje terminologjike, kamerieri pas pak na e solli gullashin, Ujin e Glinës dhe sallatën. Enigma, pra, u zgjidh, ndonëse për ne nuk ishte aq bindëse që gjella e lëngshme me copa mishi të prerë imët, të përmbajë në emrin e vet "qebap", kur ne qepabë u themi copave të mishit të grirë të pjekur në zgarrë ("skarë").

Dikur afrohet pronari duke na treguar se si është shpërngulur familja e tij nga Mali i Zi dhe e kanë bërë këtë për shkak të presionit ndaj shqiptarëve me një qëllim të vetëm që të nxisin shpërnguljen e tyre në kohën e Rankoviqit famëkeq. Na intereson se a i mban lidhjet

familjare, dhe a e ka vizituar vendlindjen tash. Jo, përgjigjet prerë pronari i restorantit

-Domethënë, ju tashmë jeni bërë qytetarë të Tiranës. Ndjeheni si tiranas apo jo?

-Ashtu disi - përgjigjet ai.

Duke e kryer darkën mbërrin ora dhjetë e disa minuta. Ne kërkojmë llogarinë për ta paguar darkën. Pronari i restorantit nuk dëshiron t'i marrë paratë. Jo, jo, i themi, haku është hak. Dhe, disi me zor, me insistimin tonë, i mori lekët, por na pyeti, duke dashur të na ndihmojë, se a kemi ku të flemë. Ne i përgjigjemi se e kemi të siguruar fjetjen e jemi vendosur në një shtëpi private.

Duke u përshëndetur dhe e falënderuar për kujdesin dhe për respektin e shprehur ndaj nesh, u larguam. Nisemi drejt banesës ku e kishim siguruar fjetjen. Na pret pronari i banesës me respekt të veçantë, si pret shqiptari mysafirët. Interesohet se a kemi pasur probleme gjatë rrugës, si kemi kaluar në doganë, e kështu me radhë. I themi se nuk kemi pasur kurrfarë problemi, porse ankohemi në marshrutën e vështirë të rrugës që vende - vende ishte pa asfalt dhe në ndërtim. "Po, është problem pak rruga e pa asfaltuar, sepse vazhdimisht po ndërtohen", thotë z.Isai, nikoqiri ynë, i cili deri tash ende kishte udhëtuar për Maqedoni. E pyesim për familjen e tij, për origjinën.

"Ne jemi nga Tirona"-përgjigjet ai, duke na bërë përshtypje theksimi i emrit të kryeqytetit të Shqipërisë, ngjashëm sikur te ne bashkëshfshatarët e mi, në vend të Bojana, do të thoshin Bojona. Gjuhë "fshatare" edhe këtu?

E pyesim për dialektin, i cili duket disi i afërt me të folmen e fshatrave përskaj magjistrales Shkup-Tetovë, prej urës së Sarajit e deri te ura e Zhelinës, të cilat bashkë përbëjnë krahinën e Dërvenit. Nuk kisha menduar më parë

se edhe në Shqipëri mund të kishte gegërishte të ngjashme me tonën.

Përderisa ne na bën përshtypje dialekti i nikoqirit, z.Isait i duket interesant fakti se afër Shkupit paska krahinë të pastër me shqiptarë. Edhe më e madhe bëhet habia e tij, kur i themi se në këtë luginë me një gjatësi rreth 50 km, ka mbi 30 fshatra shqiptare.

Duke mbaruar këtë njoftim të shkurtër, do të vijnë edhe dy mysafirë të tjerë nga Kosova. Ata interesohen se mos vallë edhe ne jemi nga Kosova. Por, kur e kuptuan se jemi nga Maqedonia, njëri prej tyre na tha: "Juve ju kemi borxh përjetë, sepse ju na e shpëtuat jetën gjatë luftës në Kosovë. Ishim të vendosur në një kamp refugjatësh fshatin e Shkupit, Bojanë".

Kur e kupton se edhe unë jam i të njëjtit fshat, ai përzemërsisht falënderohet për kujdesin që treguan bashkëfshatarët e mi për të gjithë ata refugjatë. Unë, një shkupjan me origjinë nga fshati Bojanë, nuk dua të rrah gjoks për atë që bënë bashkëfshatarët e mi, sepse, fundja, këtë e shoh si një obligim moral, njerëzor dhe kombëtar. I them: "E gjithë bota ju ka ndihmuar, e pse jo edhe ne që jemi të një gjaku. Njësoj bënë edhe kosovarët këtë vit, kur shqiptarët në Maqedoni patën probleme të ngjashme. Pra, edhe luftë, por edhe zhvendosje të popullatës njëkohësisht". Mirëpo, kosovarët mendojnë se gjatë luftës që u bë në Maqedoni, ata ishin më të organizuar, si në pikëpamje politike, ashtu edhe ushtarake, prandaj edhe fituan luftën më lehtë se kosovarët në vitin 1999. Por, ne përgjigjemi se "pa ndihmën Tuaj, pa luftëtarët tuaj do ta kishim më vështirë, prandaj edhe mirënjohjet janë reciproke".

-Po - thonë të dy kosovarët - por ju erdhët edhe gjatë luftës sonë në Kosovë, njësoj edhe me ushtarë edhe me

njerëz dhe përkrahje politike, prandaj ne e kishim borxh të reshtohemi me ju kur kishit nevojë për ne.

E më vonë do të shtojnë: "Po tash si është puna, a është qetësuar situata me Marrëveshjen e Ohrit?"

-Tash situata është qetësuar - u them - Luftime nuk ka, por vijnë fazat tjera të përmbushjes të asaj Marrëveshje që u nënshkrua në Ohër.

Dhe, përderisa kuvendojmë për hallet shqiptare, kah ora 23.30 minuta do të na ndërpritet rryma. Ne nuk e ndërpresim muhabetin por tani biseda jonë zhvendoset në temën e "rrymës". Çka u bë me këtë rrymë, a edhe ju keni probleme me rrymën, pyesin kosovarët. Të njëjtën pyetje na e bëjnë edhe ne nga Maqedonia. Ne u themi që as gjatë krizës nuk kemi pasur probleme në këtë drejtim. Isai na e sjell një qiri, dhe ashtu i revoltuar, do të na përkujtojë një sensacion gazetaresk, se në Kabul, ku ishte aksioni i bombardimeve amerikane, kundër regjimit taleban, situata me rrymën paska qenë më e volitshme se këtu në Tiranë! "Kabuli ka qenë vetëm 4 orë pa rrymë, kurse Tirana 12 orë!" thotë ai.

Vërtet, si ka mundësi që kryeqyteti i një shteti të katandiset kështu, pyesim. E pastaj u drejtohemi kosovarëve duke u thënë se Hekurana e Shkupit gjithmonë e ka shfrytëzuar rrymën e Termocentraleve të Kosovës, e tash vërtetë është e pakuptimtë se si është e mundur një gjë e tillë, kur kjo hekuranë nuk e shfrytëzon rrymën kosovare. Kosovarët duke lëvizur kokën ma bëjnë: "Edhe ne e bëjmë të njëjtën pyetje!".

Nikoqiri i shtëpisë thotë se ka rrymë, por "shteti e shet rrymën jashtë për lekë duke na lënë ne në terr!"

Duke na dëshiruar gjumë dhe natë të mirë bën pyetjen e rëndomtë se kur do të zgjohemi nesër, nëse ka nevojë më

herët, të na zgjojë ai. Por ne i themi se nuk ka nevojë të na zgjojë më herët sepse dyert e panairit hapen më vonë.

Flejmë mirë dhe në mëngjes jemi të pushuar dhe të këndellur dhe na pret kafeja e mëngjesit. Kuptohet, jemi të pushuar dhe e falënderojmë nikoqirin për kafen dhe kujdesin. Ai duke na e lëshuar televizorin vërejmë që ka shumë kanale televizive, qoftë private, qoftë shtetërore, e që në ora shtatë, si duket, të gjitha televizionet private e bëjnë shfletimin e gazetave ditore. Pra, duke i përmendur titujt më interesant, si lajme, ngjarje, e gjëra të tjera kulturore, sportive dhe ndonjë marketing e shfletojnë shumë shpejt dhe qartë tërë atë që ka qenë e rëndësishme ditën që kalon. Ne na interesonte se sa kanale private ka në Shqipëri. Z. Isai thotë se ka diku rreth 100 kanale private, por edhe që i përcjellin edhe televizionet satelitore. Poashtu, tregon se në asnjë kanal televiziv nuk ka fare censurë. Por, ka disa kanale që janë bile partiake. Ka edhe të atilla që janë neutrale. Me këto këmbime fjalësh ne e përfundojmë bisedën dhe dalim nga banesa.

Në qytet ndalemi në një restorant për të ngrënë mëngjes, në të njëjtin restorant ku ishim dhe natën e kaluar, dhe aty hamë nga një çorbë. Më pastaj nisemi në drejtim të Piramidës, dhe kur arrijmë atje takojmë dhe përshëndetemi me botues dhe librarë të tjerë. Te stenda e shtëpisë botuese SHKUPI, me ardhjen e vizitorëve të parë, ata do të interesohen së pari si është situata në Maqedoni, a janë ndalur aksionet luftarake, e a keni kaluar mirë në kufi e gjatë rrugës. Të gjithë shprehnin interesim për situatën në Maqedoni, sado që ishte edhe e mundimshme ata kishin nevojë të informohen edhe mua ma shtonte oreksin që sa më mirë t'i njoftoj për jetën, punën, shkollimin e probleme të tjera, që u interesonte për ne që posa kishim dalë nga një konflikt disa muajsh.

Në një moment te stenda do të afrohet një njeri me moshë diku 70-vjeçare dhe do të ndalet e duke u interesuar dhe duke më njoftuar se paska qenë i burgosur në kohën e monizmit dhe ishte autor i disa librave, emri i të cilit është Sokrat Shyti. Duke vazhduar kështu e kupton se jemi nga Shkupi, dhe se interesimi i tij përqëndrohet në pyetjen se a ka pasur luftime në vetë qytetin e Shkupit. Në disa fshatra në rrethinë të qytetit ka pasur luftime, mirëpo në brendi të qytetit nuk ka pasur me përjashtim të disa incidenteve, si p.sh. ngjarja në lagjen e Gazi Babës, ku në gjumë u vranë 5 pjesëtarë të UÇK-së, ngjarje kjo e cila do të nxisë disa incidente tjera me rreth 40 viktima, që nuk kishte nevojë të ndodhnin sepse, Marrëveshja e Ohrit më ishte gati për nënshkrim, kjo ndodhi ishte edhe shkaktare e vonesës së nënshkrimit.

Po Haraçina a është lagje Shkupit, pyet ai. Po, i them, ajo është një si paralagje e Shkupit, bile është komunë e veçantë, rreth 10 km larg qendrës. Atje ka pasur me të vërtet luftime e shkatërrime të mëdha e bile zhvendosje të popullatës civile, mirëpo me ndërmjetësimin e emisarëve amerikanë do të vijë deri te ndërprerja e luftimeve e më vonë edhe te pajtimi mes palëve në konflikt. Por me rëndësi është se ajo lagje nuk është pushtuar nga forcat ushtarako-policore.

"Po, e kemi përcjellë situatën rregullisht, ju na e treguat se ne jemi trashëgimtarët e Skënderbeut, se ne gati që harruam se jemi ata shqiptarët që dinë edhe të luftojnë. Ju na e ngritët moralin e humbur, se ne monizmi na bëri të varfër jo vetëm materialisht, por edhe moralisht, kështu që sistemi na e kishte nëpërkëmbur edhe dinjitetin tonë kombëtar"-thotë bashkëbiseduesi.

Duke i thënë se edhe ju erdhët në ndihmë për të mbrojtur tokën shqiptare, ai ma kthen me fjalët: "Shqiptarët

ku do që ishin erdhën në ndihmë për të luftuar, e erdhën edhe nga Shqipëria, si bie fjala komandant Teli e Shpendi. Po, e kemi të njohur këtë fakt, mirëpo luftën ju e keni udhëhequr dhe organizuar me një disiplinë të madhe që është për lavdi, thotë ai. Ne shqiptarët e Shqipërisë u treguam më frikacakë në Evropë, sepse duke menduar se si ta përmbysim komunizmin në krye me Enver Hoxhën, ne do të humbim edhe vendin që fare nuk kishte qenë e vërtetë. Me demokratizim e vendit ne u renditëm në fund të shteteve evropiane. Këtë e them jo pse unë jam një nga viktimat e shumta që u persekutuan, duke më shpallë armik i vendit, shumë epitete të shëmtuara, por ngase ashtu ka qenë gjendja. E dimë tashmë, e vërteta po del në shesh. Kushdo që kishte ndonjë mendim të ndryshëm nga pushteti në atë kohë, e pësonte. Sa njerëz ka zhdukur diktatori, sa njerëz kanë vuajtur burgjet e rënda.

Rastësisht e vëren librin e autorit të njohur të Sami Krosit me titull "Ankthi".

"Ja ku e paskeni, frika nga frika quhet ankth. Me siguri është libër i psikologjisë?"-pyet.

Jo, i tregoj, ky është libër me tregime dhe nuk ka kurrfarë lidhje as me medicinë e as me psikologji, mirëpo unë arrita të mësoj shumë gjëra nga ky zotëri i vuajtur shumë në sistemin e kaluar. Autori i "Ankthi-t" edhe pse ishte prezent, fare nuk shprehu interesim që të shpjegojë diçka në lidhje me titullin këtij libri. Z.Sami Krosi, autori sigurisht mendonte si shumë autorë të tjerë, se vepra letrare nuk shpjegohet, porse çdo lexues vetë duhet të zbërthejë idenë.

Në panair vijnë e interesohen duke i vizituar të gjitha stendat me radhë njerëz nga të gjitha moshat, nxënësit vijnë më listat për kërkim të lektyrave që iu duheshin në procesin arsimor e që kërkoheshin me planprogramin mësimor të

tyre. Duke u larguar z. Sokrat Shyti, do të na fton në kafe te biblioteka kombëtare ku më së shumti e kalonte kohën e lirë si pensionist. Përshëndetemi për t'u takuar edhe ditët në vijim.

Në stendë do të vijë edhe një zonjë e cila po ashtu kishte shtëpi botuese me emrin "Elena Gjika". Edhe asaj i bën përshtypje një titull libri, nga i po njëjti autor(Sami Krosi), por jo për "Ankthi-n" , por për librin "Filozofia e jetës në poezinë e Lasgush Poradecit".

Ajo zonjë do të shprehë një gëzim të madh sikur të kishte gjetur pasuri të patundshme: "Sa bukur, ja, e gjeta librin për Lasgushin e madh!"

Ajo e gjen edhe librin e Thoma Kacorit me titull "Ndriçime", të "rilindasit të vetëm të gjallë shqiptarë", siç e kanë quajtur, e që punon e krijon në Sofje. Ajo gjeti edhe shumë libra tjerë, menjëherë më kujtohet se kush ishte Elena Gjika një heroinë shqiptare nga Mali i Zi, e përmendur në veprën e Gjergj Fishtës së madh në librin "Lahuta e Malësisë", e tash u plotësua edhe përshtypja se pse kjo shtëpi botuese e mbante emrin e saj.

Ditën e nesërme do të vijë e njëjta zonjë vetëm e vetëm të më tregojë se autori Sami Krosi e ka studiuar më së miri poezinë, jetën, dhe vizionin e Lasgushit të madh.

"Me të vërtetë i lumtë për këtë punë të madhe!" thotë zonja, pa ditur që autori i këtij libri ishte prezent te stenda e ShB "Shkupi" dhe kur e kuptoi ajo, menjëherë edhe e fton në kafe për një bisedë më të gjatë. Autori me interesim i përcolli të gjitha ato fjalë miradie dhe ndjeu një kënaqësi shpirtërore. Me të vërejtur këtë, ajo shkon edhe më larg sa që thotë se do të bëjë përpjekje që t'i sjellë edhe vetë anëtarët e familjes më të ngushtë të Lasgushit, që në ditët në vijim edhe do të ndodhë që ishte edhe një kënaqësi plus

si për autorin ashtu edhe për mua si përfaqësues i kësaj shtëpie botuese.

Duke shëtitur nëpër panair do të njihem edhe me botuesit tjerë nga të gjitha trojet tjera shqiptare, si emra do t'i përmend emrat si Apostol Duka, Nexhati Tafa, Xhevahir Leshi e Mehmet Gëzhilli, Azem Zogaj, Nail Draga e shumë të tjerë që më vonë do ta vazhdojnë miqësinë mes nesh që do të mundëson në njohje sa më të mirë si në botime e kulturë. Me Nexhati Tafën, pronarin e ShB "Tafa" ulemi në restorant për të pirë kafe. Ai do të rrëfejë se si ka ardhur deri te veprimtaria botuese, kryesisht me botime për fëmijë. Duke pirë kafe e duke biseduar e tregon rrëfimin e vet se si ka ardhur deri te hapja e një shtypshkronje të mirëfilltë e të plotësuar me të gjitha ato mjete e aparate që i nevojiten një shtëpie botuese. Unë nuk kisha fare kushte për të nisur punën, thotë ai, por rastësisht takohem me një biznesmen nga Arabia dhe ai në bisedë më pyeti a mos kam nevojë për ndonjë ndihmë, sa i përket shtypshkronjës, që ju e përmendët? Unë kuptohet se ia tregova të vërtetën se kemi nevojë për një lloj përkrahje, dhe ai ma mori adresën e telefonin. Do ta mbajë mend atë bisedë dhe do t'i bjerë ndër mend se më ka premtuar do makina për shtyp edhe seriozisht do të angazhohet, bile i kishte siguruar dhe do t'i dërgojë me anije dhe mua rastësisht më vjen një kartolinë nga posta ku më informonte se më ka ardhur një paketë që e ka dërguar një biznesmen nga Arabia. Unë menjëherë nisem me furgonë duke menduar se do të mjaftojë, mirëpo, kur arrita atje, doganieri e pa se nuk do të ketë mundësi të merret ai paket. Shefi më shikoi me habi sepse, më tha se me furgon nuk do të mund ta transportoj atë makinë të madhe.

"Kjo makinë, zotëri, është e rëndë 7 tonë!", më tha doganieri, duke krijuar tash te unë habinë dhe befasinë më

të madhe në jetën time! Isha i detyruar të marr kamion që do t'i përgjigjej asaj peshe", rrëfen ai, duke admiruar këtë gjest të rrallë bujar nga një i huaj.

Shtëpia botuese "TAFA" kryesisht merret me botimet e revistave për fëmijë. Deri tani ka botuara diku mbi 300 numra të revistave për fëmijët e moshës parashkollore e shkollore të arsimit të ulët. Kjo shtëpi botuese është më e njohura në të gjitha trojet shqiptare, të cilën e udhëheq vetë Nexhati Tafa me bashkëshorten, dhe fëmijët e tyre, të cilët iu ndihmojnë me përgatitjen kompjuterike si dhe në procesin e botimeve e të shtypjes në përgjithësi. Në bisedë me zotëriun do ta shfrytëzoj rastin që drejtpërsëdrejti t'ia jap ftesën për panairin e librit që do të organizohet në Shkup. Ai ftesën e mori me kënaqësi, me një kureshtje, sepse do ishte hera e parë të vinte në Shkup. Kështu, duke pirë kafe edhe u bëmë miq të vërtet sot e kësaj dite.

Në Shqipëri, në qoftë se do të blesh diçka me valutë botërore si me marka apo dollarë nëpër dyqane, ata të drejtojnë që t'i thyesh në "zyrën e këmbimit"(këmbimore, siç e themi ne) e mandej të shërbejnë. Vërehet edhe një dallim tjetër - bananet që te ne shiten me kilogramë, këtu shiten me copa, të gjitha pemët e perimet mund t'i gjesh në çdo kënd të rrugës përveç në treg, nëpër dyqanet e shumta. Këtu në Shqipëri menjëherë të vërejnë se nuk je banor i vendit po sa të fillosh të komunikosh me ta, sepse bie fjala ne për automobil përdorim disa terme auto, veturë, kerr, dramë e ngjashëm, kurse ata e përdorin termin makinë që ne me atë termë kuptojmë shumë sende, si bie fjala makinë për të ndezë cigaren e deri te shumë llojeve të makinave që përdoren në industri e veprimtari të ndryshme. Në bisedë rastësisht me një shok të Tiranës edhe e hapëm temën e makinës. Këto sqarime që i përmenda më lartë ai pranon,

duke thënë se ashtu është edhe pse në Shqipëri ka hyrë në fjalorin e përditshëm gabimisht.

Afër stendës tonë ishte një librar i cili kishte ekspozuar kryesisht libra për konfesionin islam. Personi që rrinte te stenda rregullisht i falte kohërat e namazit, dhe kur do të vinte koha e namazit, ai më tregonte mua se është duke shkuar në xhami, dhe më luste të kujdesem edhe për librat e tij. Kështu, si fqiu i parë nuk kisha kurrfarë problemi. Librat e tij i shikoja si të mijtë, duke u munduar të mos refuzoj asnjë myshteri dhe kur kthehej ia jepja paratë për qindarkë.

VIZITË MUZEUT KOMBËTAR HISTORIK "SKËNDERBEU" NË KRUJË

Por një ditë edhe unë do të veproj ashtu, por unë këtë herë do të nisem më larg se në xhami. Me Sami Krosin vendosëm që ta vizitojmë muzeun kombëtar shqiptar në Krujën historike e legjendare. Dhe kuptohet, librat do t'ia lë në përgjegjësi fqinjit të parë që e kisha më afër, edhe ia shkrova tërë çmimet për secilin libër. Ia bëra me dije se do të vonohemi dhe e lutëm që gjatë asaj kohe ai të kujdeset

për stendën tonë. Dhe ky ishte rast i mirë që ta vërtetoj atë faljen e tij që shkonte në xhami. Por, çka ndodhi? Kur u kthyem nga Kruja, ai më tha se kishte shitur vetëm një libër!

U mllefosa me këtë neglizhencë ose pa interesim të tij, por nuk desha t'ia shprehë. Unë pastaj 18 e deri në ora 20.30 do të shes libra me vlerë diku 10000 lekësh, ndërsa ai për disa orë kishte shitur vetëm një libër që ishte shumë shenjë jo e mirë për njeriun që nuk i lëshonte 5 kohët e namazit. Me një fjalë, unë e pashë atë se ai kishte qenë një besimtar jo i devotshëm, një egoist çfarë nuk mund të jetë një besimtar, sepse ai "përkujdesjen" për stendën time e kishte kuptuar vetëm për t'i ruajtur librat, e jo për t'i shitur dhe e mora me mend se ai praktikisht i kishte i përzënë myshterinjtë me fjalët se pronari kthehet për nja 20 minuta!

Kurse në Krujë, përndryshe, kaluam bukur. U nisëm me furgon. Duhet përmendur se bileta e udhëtimit është shumë lirë – deri në Krujë nuk të kapë as një markë gjermane. Vendi nga nisemi quhet Zogu i Zi, do të kalojmë nëpër një qytet tjetër me emrin Fushë Krujë nja 25 km larg Krujës. Vërejmë se rruga e asfaltuar është e mirëmbajtur. Kruja është e njohur për monumente të shumta, për shtatore Skënderbeut në qendër të qytetit dhe çarshinë nëpërmjet së cilës kalohet për te Kalaja legjendare që tërheq turistë e vizitorë të shumtë nga trojet shqiptare e nga tërë bota. Duke kaluar mespërmes qytetit, ne do të vërejmë shumë rrugica me gurë, të ngushta të ndërtuara ndoshta që në kohën e Skënderbeut e më herët bile. Ngadalë ngjitemi drejt kalasë së vjetër, dhe ne nuk e dinim se aty është hyrja me lekë, dhe ne u afruam te dera e muzeut dhe u futëm brenda, mirëpo një zonjë e punësuar në muze menjëherë do të reagojë me vërejtjen se ku jeni nisur, sepse hyrja këtu paguhet.

Autori i librit në Qafë të Krrabës

Ne jemi nga ata që nuk paguajnë, i themi në shaka, jo për t'i ikur pagesës, por për të krijuar atmosferë humori.

Mirëpo, njerëzit e kuptojnë seriozisht.

Aty ndodhet një kosovar, i cili i thotë zonjës se këta janë nga Maqedonia, "ku luftohet".

Kur ne i bëmë paratë për të paguar biletat, zonja me një xhentilesë na thotë se nuk ka nevojë. Për ju është e lirë hyrja!

Shikohemi me habi mes veti, të insistojmë edhe më tutje për të paguar biletën, por në fund e falënderojmë përgjegjësen e muzeut për këtë bujari, dhe hyjmë pa biletë. Në muze duket sikur nga çdo kënd ndjehet fryma e kryetrimit shqiptar, sikur vringëllon shpata duke u prerë kokat turqve pushtues të dheut të arbërit. Shohim në murë shumë pamje luftimesh, helmeta, shpata, shigjeta, por dhe shumë akte e dekrete, dokumente të kohës dhe shumë artikuj gazetareskë të botuar nëpër libra e revista shkencore. Por më së shumti të bën përshtypje një libër që është aty ku secili vizitor mund të shkruajë disa fjalë në lidhje me vizitën duke e vënë në fund edhe nënshkrimin e vet. Krejt rastësisht para meje si vizitorë ishte bashkë me familjen e vet edhe patrioti i madh shqiptar, Hysen Tërpeza i cili luftoi për kauzën shqiptare deri në pikën e fundit, i cili një kohë të gjatë jetoi në Turqi mirëpo menjëherë pas çlirimit të Kosovës kthehet në vendin e vet. Duke u nënshkruar si vizitor, do të shkruaj: Edhe unë pra e kreva obligimin tim personal që ta vizitoj këtë shenjtore të shqiptarëve. Me këtë rast e ndjeva veten disi më të lehtësuar që e mbaja tërë jetën se e kam obligim moral për ta bërë një vizitë të tillë.

Me këtë rast pamë edhe Muzeun Etnologjik që ishte po në të njëjtin kompleks të kalasë. Në dalje do ta bëjmë një

fotografi për kujtim. Në atë kompleks vlen të përmendet edhe ora e ndërtuar në formë kulle prej guri, që në ato kohëra ka shërbyer si matëse e kohës, e cila ishte meremetuar disa herë gjatë ekzistimit të vet. Kjo vizitë do të jetë një vizitë e paharruar.

Pastaj do të hyjmë në një restorant tradicional, ku do të marrim nga një oriz, specialitet ku e gjen vetëm në Krujë e askund tjetër dhe do të pijmë "Ujë Gline", po ashtu i pa konkurrencë si pije freskuese. Unë i propozoj Sami Krosit që të dalim edhe t'i biem rreth e qark qytetit. Ai do të më refuzojë me fjalët e veta karakteristike se sa vjet i ka. Ti je 20 vjet më i ri se unë, në qoftë se ke mundësi të m'i heqësh nja 10 vjet atëherë pajtohem, më thotë ai. Me këto fjalë mbaron vizita jonë në qytetin e Krujës legjendare.

Duke u kthyer për Tiranë, kalojmë nëpër parkun nacional, të rregulluar ashtu për lakmi. Gjatë rrugës përveç bunkerëve të shumtë kemi rastin t'i shohim edhe furrat e shumta për prodhimin e gëlqeres, që mund të konsiderohet si karakteristike për Krujën. Tash e lamë pas Krujën dhe në hyrje të Tiranës është një lumë i vogël, me pak ujë. Por, ata persona që i pyetëm nuk mundën të na e tregonin emrin e lumit.

Më në fund arritëm te panairi i librit, te Piramida.

Si përmenda më lartë, veprimi i "fqinjit" që më kishte shitur vetëm një libër edhe më tepër më forcoi bindjen se shumë prej tyre që mbahen fetarë, janë pesë pare burrë!

Sheshi i Tiranës është i tillë, ku prej aty fillojnë të gjitha rrugët kryesore, e turisti e ka shumë lehtë të orientohet. Assesi nuk mund ta humbë rrugën për në hotel, apo ku do që të shkojë. Arritëm te banesa ku ishim të vendosur, menjëherë edhe e lëshojmë TV-në, të shohim si vejnë punët në Maqedoni me dorëzimin e armëve dhe amnistinë, si pjesë të Marrëveshjes së Ohrit.

Televizioni tregon edhe lajme nga Afganistani ku lufta vazhdon. Kërkojmë kanalet tjera, gjejmë një transmetim të ndeshjes futbollistike Bresha - Milan në kampionatin italian, që edhe ishte cilësore, por neve na interesonte sepse në ekipin e Breshës luante edhe qendërsulmuesi i kombëtares Shqiptare Igli Tare. Ndeshja ishte e fortë dhe do të përfundojë me rezultat baras 1-1, kjo për ekipin e Breshës është rezultat i volitshëm sepse, ekipi i Milanit i ka mbledhur lojtarët më në zë në botë, si Shevçenko, Kafu, Birhof e shumë të tjerë. Këtu në bisedë për futboll, ndërlidhet nikoqiri i shtëpisë duke thënë se Shqipëria ka shumë lojtarë cilësorë, por lipset ndonjë seleksionues i mirë që do të mund t'i komponte në një ekip të fortë që të luajnë bashkë, e mendoj se edhe rezultatet vetvetiu do të vijnë. Një kosovar që ishte në shoqëri me ne do të propozojë që të thirren të gjithë futbollistët shqiptarë ku do që janë. Një kombëtare e tillë do të ishte e denjë të marrë pjesë në të gjitha garat ndërkombëtare madje dhe të kualifikohet në një finale evropiane apo botërore, që është edhe ëndërr e të gjithë shqiptarëve kudo nëpër botë. Do të ndërlidhem edhe unë pak, mendoj se në qoftë se reprezentacioni i Kosovës, pranohet një ditë në FIFA dhe UEFA, ka gjasa të mira për rezultate të lakmueshme, me shpresë se një ditë, edhe do të bëhet realitet. Sa u përket sporteve të tjera, Kosova ka shumë sporte tradicionalisht të forta si boksi, basketbolli, hendbolli, mundja e atletika, prandaj mendoj se atje ka vend edhe për rezultate të mira. Do ta përmendi vetëm boksin, si shembull në kohën e Jugosllavisë të Titos, ku liga e federatës ishte shumë e fortë, e merrni me mend klubi i Prishtinës ishte 7-8 herë kampion i Jugosllavisë. Me boksierët e saj më të njohur si Nazif Gashi, Mehmet Bogujevci, Xhevdet Peci, Bajram Hashani e Aziz Saliu e

shumë të tjerë si nga Kosova por edhe nga Maqedonia, nuk kishte të ndalur.

Sa i përket sportit në Maqedoni, ai është më i zhvilluar. Mundja e cila u bë shumë e njohur falë mundësve shqiptarë, si Shaban Sejdiu, Shaban Tërstena, Bajram Qorolli, Lulëzim Vranezi e shumë të tjerë, por edhe boksi është i afirmuar mjaftë në Maqedoni.

Si njeri i cili ka kontribuar në sportin shqiptar është pa konkurrencë Mentaz Allajbegu, i cili edhe e merr epitetin trajneri më i mirë i të gjitha kohërave në trojet shqiptare.

Mirë është mbasi arritëm që të çlirohemi nga okupimi shekullor serb, ndërlidhet njëri nga kosovarët në këtë shoqëri të ngushtë në banesë, e vazhdon mandej duke përkujtuar se në okupimin serb asnjëherë nuk i shkuar mendja, as në gjumë bile se do të vijë momenti, kur do të tërhiqen tërësisht ushtria e policia serbe, e ja, falë luftës dhe ndihmës që ua dha tërë bota, me Amerikë e Evropë, ia arritën qëllimit. Bota e pa fytyrën e vërtetë të regjimeve fashizoide serbe, mirëpo u mbush kupa e së keqes dhe ja sot Millosheviqi akuzohet nga Tribunali i Hagës për krime të luftës në Kosovë, Kroaci e Bosnjë. Le t'i tregojë ato të vërteta që ne i kishim të njohura se edhe në Maqedoni vinin ato eksperimente të Kosovës por me tjera metoda e përmasa. Pra, duke falënderuar bombardimet e NATO-s e Amerikës me aleatët e vetë, më në fund arritëm lirinë që sot e kemi në Kosovë e bile ku do që ka shqiptarë në botë.

Fillon dita e tretë e panairit të librit në Tiranë. Siç përmenda më parë libri "Shqiptarët e Ukrainës" zgjoi interesim jashtë zakonisht të madh, me autorë Sefer Musliun e Daut Dautin, të cilët tashmë shumëkush i njihte nga emisionet dokumentare me reportazhe nga Ukraina, të emetuara më parë në televizionin satelitor, si një befasi e rrallë dhe secili që e vërente librin e blinte për ta pasuruar

bibliotekën e vet. Këtë libër e vëren një banor i Tiranës, i cili e kish prejardhjen nga Çamëria, por aty do t'i intereson se a ka mundësi të bëhet një libër i ngjashëm si ai i shqiptarëve të Ukrainës, unë do mundohem t'ia shpjegoj mënyrën e botimit se si ne e kemi bërë. Pa gjetur ndonjë sponsor që ta përkrahë atë, nuk mundemi ta botojmë në rrezikun tonë. Ia bëj me dije se në qoftë se gjejnë sponsor le të lajmërohet te ne në Shkup, se për botimin e librit fare nuk do ketë problem.

Duke bërë një vizitë stendave tjera të panairit, do ta vërejë një poster të heroit legjendar, Adem Jashari me ish liderin e UÇK Hashim Thaçin, ku ishin fotografuar para fillimit të luftës diku në Drenicën krenare. Kuptohet se këtë fotografi, do ta kem në pronësinë time, duke u prezantuar e njoftuar me përfaqësuesin e revistës "Koha".

Në stendën tjetër do të vërej diçka tjetër, hartën gjeografike të Kosovës, të cilën poashtu do ta siguroj. Mandej duke u afruar te stenda e SHB "Argeta", do ta vërej librin e mikeshës së madhe të shqiptarëve, pra, të autores angleze Edit Durham. Ajo do të frymëzohet aq shumë që për kulturën dhe traditën shqiptare, do t'i shkruajë edhe dy librat e saj ku i paraqet shqiptarët si të civilizuar e me kulturë të lashtë që luftuan për atdheun e tyre qysh në kohët e para, e pas Skënderbeut, ajo për shqiptarët do të thotë se secilin që ta pyesësh se çka je, pa hamendje e merr përgjigjen e njëjtë "Jam shqiptar", që nuk është karakteristike për popujt tjerë ballkanas. Duke u njoftuar me pronarin e SHB "Argeta", me zotëri Mehmet Gëzhilli, një njeri mjaft i ngritur intelektualisht e me njohuri të mëdha për kulturën shqiptare, jo vetëm që nuk dëshiron t'i marrë lekët prej meje, por do të më ftojë në kafe. Si autor i shumë librave, ai do të propozojë shumë plane interesante, si për shembull, mundësinë e hapjes së një salloni të librit

në ndonjë lagje të Shkupit, që do t'i ketë librat e të gjitha shtëpive botuese shqiptare. Duke treguar se në Prishtinë ekziston një sallon i tillë, thotë se do të kishte qenë i mirëseardhur edhe në Shkup një i ngjashëm. Shkupi dikur ka qenë qendër e gjithë shqiptarëve dhe pse mos të kthejë atë renome që e ka pasur, thotë ai. Nga shkaku se në Shkup kalojnë të gjithë ata njerëz të rëndësishëm, që janë faktorë të politikës botërore. Shkupi ka qenë qytet me më shumë shqiptarë deri 50 vjetësh, ku kemi qenë edhe shumicë, por me krijimin e Maqedonisë pas 45-tës, pushteti do të stimulojë maqedonasit të vijnë prej anekënd vendit dhe kështu tash ata janë shumicë. Ne shqiptarët do të mbesim në kompaktësi në një pjesë të qytetit të quajtur Çair, ku do të mbetemi pakicë në krahasim me maqedonasit edhe pse të gjithë të ardhur nga pjesët tjera të Maqedonisë. Për këtë shkak, edhe është propozimi juaj, shumë me vend që të hapet një sallon i tillë i librit në këtë qytet. Mirëpo, me që e përmendët këtë gjë për Shkupin, unë po ju ftoj qysh tani që të vini në panairin e librit në Shkup. Kjo bëhet me një qëllim të kthimit krenarinë e dinjitetin Shkupit si themeli i kulturës shqiptare, ku luftoi Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Idriz Seferi. Duke iu përgjigjur pozitivisht ftesës sime për panairin e Shkupit, ai më tregoi se ka qenë pjesëmarrës edhe në një panair tjetër, të quajtur Panairi i Librografisë, poashtu në Shkup.

Organizatori i panairit të librit do të kumtojë promovimin e librit të shkrimtarit të madh shqiptar, Ismail Kadaresë, me titull: "Ra ky mort e u pamë" të shtëpisë botuese "Onufri". Pastaj shtoi se do të vij edhe vetë autori. Dhe vërtet, Kadare do të vijë me bashkëshorten e vet Elenën dhe me shumë miq e dashamirë të tjerë e i udhëhequr nga editori i shtëpisë së përmendur, Bujar Hudhri. Me të vërtetë shkrimtari i madh do të jetë aktual në çdo moment e i

freskët në mendime e ide dhe se duke i përcjellë ngjarjet politike, kulturore e ushtarake edhe do ta emërojë librin me atë emër shumë karakteristik. A thua mund të ketë mendim më të saktë e më karakteristik se ky, sepse shqiptarët me shumë halle, në jetën e tyre në ekzil, e kurbet, të shpërndarë në gjithë botën, në Amerikë e perëndim të Evropës, por në rast gëzimi, morti e hidhërimi, për një luftë, në një çast do të mblidhen bashkë. Gjatë luftës në Kosovë, nga Amerika do të vijë batalioni me shqiptarë të Amerikës me emrin "Atlantiku" për t'u ndihmuar luftëtarëve të lirisë dhe me të ardhur ata shprehnim gëzimin e tyre që iu dha rasti ta mbrojnë tokën iliro-dardane.

Në ditën e parafundit të panairit vijnë vizitorët t'i blejnë librat që i kanë parë ditëve të kaluara. Ne si përfaqësues edhe nuk e dimë se gjithnjë kush e ka vizituar panairin. Në stendën e panairit do të vijë edhe atasheu i ambasadës së Maqedonisë në Tiranë me në krye ambasadorin Risto Nikovski. Me të ardhur aty do të ndalet e duke përshëndetur dhe shprehë interesimin dhe respektin e vet për botuesit nga Maqedonia. Ai ndërlidhet se këtu qytetarët shqiptarë kanë shumë interesim të madh për libra dhe lexues, më shumë se sa në Maqedoni. Mua kjo më gëzoi shumë që edhe vetë e pashë dhe u vërtetova për këto fjalë që erdhën nga një diplomat maqedonas.

Ambasadori Nikovski duke dashur që të bisedojë më gjatë do të na ftojë në kafe në lokalet e ambasadës dhe duke na e dhënë edhe telefonin e ambasadës largohet nga stenda. I premtoj se nëse më jepet një mundësi më e vogël do të shkojmë për kafe. M'u kujtua ajo karakteristikë tipike ballkanase se kur largohemi nga vendlindja, ne i harrojmë gjithë grindjet, e hallet e për një moment gjejmë gjuhë të përbashkët. Posa u largua delegacioni i ambasadës së Maqedonisë, do të vijë një njeri i moshuar, cili si shumë të

tjerë, do të tregojë interes për Maqedoninë. Është ky Ilinden Spasse, djali i shkrimtarit të njohur Sterjo Spasse. Në pyetjen time se a është ai maqedon, ai përgjigjet se babai i tij është shkrimtar shqiptar, por ka disa libra që dëshiron t'i dërgojë në Maqedoni, për lexuesit shqiptarë dhe ata maqedonas. Bile edhe ashtu e kishte titullin libri "Miqësia shqiptaro-maqedonase", në të cilin janë shënuar rrugët e kanalet miqësore midis dy popujve të Ballkanit.

Unë nuk kam asgjë kundër, në qoftë se m'i dhuroni librat, por nuk mund ta marr për obligim shitjen e tyre sepse nuk kam librari, i them. Mandej, vjen delegacioni i ambasadës së Bullgarisë, i cili poashtu shprehu interesim për librin shqip, të cilët komunikonin shumë bukur në gjuhën shqipe. Ata e vërejtën librin "Ndriçime" të shkrimtarit Thoma Kacorit, i cili është edhe profesor dhe shef i katedrës së albanologjisë më Sofje. Ajo tregon se autorin e librit e ka pasur profesor të vetin në atë katedër. Për çudi do t'i merr të gjitha librat e Thoma Kacorit. Kontaktet me diplomatë janë mjaft interesante, sepse ata vijnë me një qëllim që të siguronin librat për të njohur sa më mirë vendin dhe popullin ku janë në mision diplomatik. Lënë përshtypjen e njerëzve të përzemërt dhe tepër komunikativë.

Ditën e fundit unë në emër të shtëpisë botuese "Shkupi", do t'u dhuroj librat disa institucioneve më të rëndësishme të Shqipërisë, Akademisë, Universitetit, Bibliotekës Kombëtare etj. Me këtë unë edhe dua të vërtetoj atë që i premtova doganierit se librat nuk do t'i kthejmë në Maqedoni. Poashtu, ditën e fundit do ta bëjmë një lirim të çmimeve, në nivel aq simbolik që asnjë lexues i interesuar të mos kthehet pa libër. Mund të konstatojmë lirisht se Tirana, qytet me afro një milionë banorë, ka shumë lexues e me atë

potencial intelektual, pa dyshim e mbanë vendin e parë në Ballkan.

Mbas mbarimit të panairit të librit, unë dhe Sami Krosi bashkë do të interesohemi për t'u kthyer në Shkup, mirëpo ishte mbrëmje e me atë qëllim që nga kthimi të shohim më mirë tokën shqiptare, vendosëm të nisemi nesër në mëngjes, që udhëtojmë ditën. Mirëpo ne nuk e kishim ditur, se autobusi për në Shkup, nuk niset në mëngjes por vetëm në mbrëmje, e ky ishte shkaku kryesor që të bëjmë një ekskursion deri në Durrës. Udhëtojmë ne me trenin i cili është i mbushur me udhëtarë deri në karrigen e fundit, e kishte shumë gjallëri e lëvizje të udhëtarëve që nuk është aq karakteristike për trenat në Maqedoni. Udhëtimi me tren është një kënaqësi e vërtetë, sepse ke mundësi që rehat-rehat të vështrosh të gjithë ato bukuri natyrore, por dhe disa atraksione, si bunkerët e shumtë që përkujtojnë një kohë të mbrapshtë të regjimit komunist.

Vetvetiu shtrohet pyetja, a thua me atë material që janë ndërtuar ata bunkerë të shumta ka mundur të ndërtohen rrugët, që do të ishin shumë më të dobishme për banorët e Shqipërisë, por kjo është temë e hapur për diskutim. Në Shqipëri turisti do të vërejë sa male të larta janë bërë toka të punuara e të mbjella me ullinj, fiq, portokaj, mandarina e me "molla Japonie" siç i quajmë pemët që në Shqipëri i fusin në familjen e hurmeve.

Më në fund arritëm në Durrës dhe një njeri do të na afrohet e do të na pyesë se mos vallë jemi nga Tropoja.

-Ne nuk jemi nga Tropoja por nga Shkupi - i themi.

-Po ju po flitni një dialekt të ngjashëm si ata - na e kthen ai.

-Po përse është me rëndësi nga jemi? - e pyesim.

-Vetëm pyeta se më bëri përshtypje e folmja juaj. Por ajo që mua më intereson është se a ju duhet dhomë për fjetje?

I tregojmë se nuk kemi plan të qëndrojmë dhe vazhdojmë shëtitjen deri te plazhi. Plazhi në këtë kohë është i braktisur, porse dallgët e detit krijojnë një gjallëri, sadopak. Këto valë sigurisht u shkakton telashe anijeve të shumta që bartin udhëtarë nga limani i Durrësit në drejtim të bregdetit italian, por dhe transporton mallra nga shumë anë të botës.

E kaluam një ditë atje, kurse në mbrëmje nisemi për Shkup, me keqardhje që nuk na u plotësua dëshira që të udhëtonim ditën.

Me të arritur në doganë, tash doganieri vetëm e bën një kontroll të rëndomtë. Duhet ta përmend faktin se bashkudhëtarët, nga Maqedonia të cilët kishin shkuar që ditën e kaluar sepse kishin pasur më shumë njohuri për nisjen e autobusit për në Shkup, e kalojmë kufirin pa problem e tash hymë në Maqedoni nga udhëtimi të lodhur.

Në Shkup arritëm diku kah ora 8 në mëngjes.

PANAIRI I LIBRIT "KORÇA 2002"

(7-9 mars 2002, tek Biblioteka Kombëtare e Qytetit të Korçës)

Arrin ftesa për pjesëmarrjen në panairin e librit në Korçë. Të shkojmë a mos të shkojmë? Do të jetë si panairet kryesore (ato që mbahen në kryeqytetet shqiptare), apo më ndryshe. Do të ketë lexues dhe blerës...? Janë këto dilema që ne si botues i këmbejmë mes veti para se të nisemi. Por, shumë botues heqin dorë të marrin pjesë në një panair lokal. Mbetemi vetëm "Vatra" dhe "Shkupi".

Nisemi bashkë me Halil Zendelin me veturën e tij në mëngjes dhe shumë shpejtë arritëm te kufiri ku në kontrollimin e parë në anën maqedonase fare nuk kemi pengesa, por te ajo shqiptare i bënë telashe Halilit se nuk e kishte rregulluar patentën e shoferit. Vonohemi pak në kufi deri sa i bindëm autoritetet që të na lëshojnë. Pasi kalojmë pikën kufitare të Qafëthanës, dalim në rrugën kryesore dhe kthejmë në të majtë duke vazhduar udhëtimin brigjeve të Liqenit të Pogradecit, siç ka pasur dëshirë ta quajë vetë shkrimtari i madh shqiptar Lasgush Poradeci Liqenin e Ohrit në anën e Maqedonisë. Me të vërtet në anën e Shqipërisë fitohet përshtypja se është më i pasur me peshq dhe se peshkataria atje është më e zhvilluar, se me të vërtet ka gjallëri më tepër për dallim nga ana maqedonase, rruga është e mirë dhe shumë shpejt arritëm në Pogradec e më vonë edhe në Korçë, por atje një polici nuk na lejon të afrohemi me veturë te Biblioteka, për shkak se do të vijë kryeministri i vendit, Pandeli Majko. Patjetër duhet respektuar urdhërin dhe e parkojmë veturën diku më larg dhe detyrohemi t'i mbajmë librat në dorë. Mirëpo, na ndihmoi edhe një hamall vendas.

Ky panair i librit mbahet në lokalet e bibliotekës së qytetit e cila karakterizohet si biblioteka më e pasur me fondin e librave, jo vetëm në Shqipëri, por dhe në Ballkan. Vërtet Korça është një djep kulture, dëshmon dhe muzeu i shkronjave të abetares në afërsinë e bibliotekës së qytetit, por edhe shumë xhami, e kisha edhe shumë monumente tjera historike, të kulturës sonë kombëtare. Por, madhështinë duhet ta shtojnë edhe fabrikat të cilat ishin gjigante të industrisë shqiptare në kohën e monizmit, por të cilat janë katandisur pas dore për shkak se koha e asaj teknologjie ka mbaruar. Siç përmenda më lart, në hapjen e panairi të librit, do të vijë kryeministri i Shqipërisë, Pandeli Majko i shoqëruar nga Servet Pëllumbi, Moikom Zeqo, Rexhep Qosja. Kryetari i SHBSH-së Fatmir Toçi, duke e hapur panairin e duke i përshëndetur botuesit shqiptarë, do t'ua jep fjalën edhe disa udhëheqësve të përmendur, e mandej bashkë me këta funksionarë të lartë, do ta fillojnë shëtitjen nëpër shtëpitë botuese. Duke ardhur delegacioni shqiptar do të përshëndetet, ndërsa kryetari i SHBSH-së do të prezantojë shtëpinë tonë botuese se jemi një ndër të parët që kanë filluar me botimin e librave në hapësirën mbarëshqiptare, kuptohet, si shtëpi private botuese dhe se këta i kemi një ndër pjesëmarrësit më të rregullt nëpër panairet tona, dhe se ne jemi bërë një trup i përbashkët, pa marrë parasysh se a jemi në Kosovë, në Shqipëri apo në Maqedoni. Poashtu, kryeministri Pandeli Majko duke u përshëndetur do ta hedh një shikim në botimet e kësaj shtëpie, i bie në sy titulli i librit me "Shqiptarët e Ukrainës", duke i ndërlidhur se e paska parë një emision televiziv ku rrëfen për jetën e tyre në Ukrainë.

Në mbrëmje organizatori i panairit e kishte siguruar një darkë solemne enkas për botuesit pjesëmarrës, ku do të jenë të ftuar edhe zotërinjtë Moikom Zeqo, Rexhep Qosja,

kuptohet edhe ne si botues nga Maqedonia. Para se të fillojë darka solemne, organizatori ia dha fjalën Moikom Zeqos, i cili ishte edhe drejtor i Muzeut Historik e Arkeologjik në Tiranë. Duke ngritur dollinë, ai tha se e ngre këtë gotë me gëzim e për bashkimin e shpirtit shqiptar që arrin t'i bashkojë të gjitha pjesët etnike shqiptare e duke u gëzuar se në këtë darkë është i nderuari akademik Rexhep Qosja e nga Maqedonia përfaqësuesit shqiptarë edhe mandej fjalën ia jep akademik Qosjes. Ai tha:"Rakinë e pi aq sa e pi, por se e ngre këtë dolli për hir të bashkimit të kulturës shqiptare e fjalës së bukur të shkruar shqipe e cila ishte e diskriminuar me shekuj të tërë, e dënuar, e persekutuar e duke vuajtur në burgje vetëm e vetëm pse është shkruar shqip".

Pasi darkës solemne, do të dalim në një njoftim të shkurtër të qytetit, i cili karakterizohet me një pastërti të nivelit më të lartë dhe i rregulluar e me shumë monumente të vjetra të kulturës shqiptare e shumë fabrika që dikur ishin kapacitete të industrisë shqiptare. Korça e njohur edhe me serenatat e njohura korçare e shumë gjëra tjera që e karakterizojnë si qytet ku lindi edhe shkolla e parë shqipe.

Panairi i Korçës mbahej prej 7-9 mars, që do të thotë dy festa të bashkuara, dita e arsimtarëve dhe dita e grave. Këto dy festa në Shqipëri festohen më respekt të madh e me manifestime të shumta, e panairi i librit ishte një nga ngjarjet që u kushtohet festave të përmendura. Mirëpo, nga ana tjetër, ky ishte edhe shkaku që numri i vizitorëve të mos jetë si i ka hije një panairi me plotkuptimin e fjalës. Kjo për ne pjesëmarrësit edhe nuk është edhe shumë problem se do të na jep mundësi që të kemi më shumë takime e biseda të ndryshme e një ndër to edhe me Moikom Zeqon, një autor me vizion të qartë për kulturën tonë e me një njohje të pasur që kishte për gjenezën shqiptare. Bashkë me

Halil Zendelin dhe Moikomin, do ta pimë një kafe në hotelin "Kristal", përballë Bibliotekës. Në këtë takim do të jetë edhe Memet Gëzhilli i ShB "Argeta" nga Tirana, që me të vërtetë ishte kënaqësi të bisedosh me një tavolinë me këta njerëz. Mandej do ta përmendë një rast ku te stenda jonë afrohet një njeri mjaft i moshuar që i kishte kaluar të 80-tat e me një shëndet ende të mirë e me fuqi që me një njoftim tejet të përsosur do ta fillojë një rrëfim të vetin për gjërat të ndodhura para luftës së dytë botërore. Ai duke treguar se është nga Pogradeci e se akoma i ka të freska kujtimet e atëhershme bie fjala për Manastirin e Shën Naumit që ndodhet në pjesën e Maqedonisë.

"Më kujtohet kur djemtë e vajzat shqiptare i bënin martesat e kurorëzimet dhe rituale e lutje fetare pikërisht në atë manastir ortodoksë shqiptar. Kjo shumë lehtë mund të vërtetohet sepse ato shkrime sllavishte mbi ikonat e manastirit janë të shkruara shumë vonë. Por kam qenë në Maqedoni dhe kam vërejtur shumë objekte të bukura fetare si xhami të ndërtuara në 100 vjetët e fundit të historisë sonë që i dua dhe i respektoj shumë, sepse ata janë ndërtuar me mjetet tuaja të ndara nga vetë shqiptarët e Maqedonisë. Edhe pse unë i takoj konfesionit ortodoks, ato monumente fetare i konsideroj si të miat sepse janë pasuri e kulturës shqiptare. Prandaj mos t'i harrojmë pasuritë tona që na takojnë neve e dikush t'i përvetësojë", flet ai, duke kërkuar falje se mos bëhet i bezdisshëm me këto shpjegime.

Mund të konkludojmë se ky panair sa i përket asaj anës së njoftimit e bisedave të shumta që i patëm, mund të thuhet lirisht se e arsyetoi, mirëpo sa i përket anës financiare, ai nuk na i mbuloi as shpenzimet tona. Por, disa gjera nuk maten vetëm nëpërmjet prizmit të parasë.

PANAIRI I LIBRIT "SHKUPI 2002", I PARI ME PËRMASA MBARËKOMBËTARE

Të gjitha paralajmërimet flasin se panairi i librit "Shkupi 2002" do të jetë i suksesshëm. Ai është i pari të cilin botuesit shqiptarë e organizojnë në Shkup, në lokalet e Teatrit Shqiptar në Bit Pazar. Ky panair mbahet menjëherë pas konfliktit të armatosur që ndodhi në 2001, prandaj i bëjmë respektin një ish-pjestari të UÇK-së që ta hapë atë. Është ky poeti i ri kumanovar, Hajrulla Misini, emri konspirativ i të cilit gjatë luftës ishte "Komandant Shpati". Duke i përshëndetur mysafirët e pranishëm, ai midis tjerash tha se me manifestimin duam t'i tregojmë botës, se pikësynimi ynë është libri, arti kultura e jo gjërat e imponuara, cënimi lirisë, mohimi i traditës shekullore që deshi dikush të na humbë kulturën shqiptare. Ne nuk e lejuam e nuk do ta lejojmë edhe në ardhmëri, e Shkupi si qytet i vjetër e me traditë të pasur do ta kthejë krenarinë dhe dinjitetin e popullit shqiptar. Prandaj, ky manifestim kulturor, ka rol historik, se për herë të parë mblidhen botuesit nga trojet mbarë shqiptare, e për mua ky është nder i madh që m'u dha rasti të bëj hapjen solemne.

Në hapje ishin të pranishëm edhe profesorët Xhevat Gega e Avzi Mustafa, botuesit Fatmir Toçi, Azem Zogaj, Apostol Duka, Mehmet Gëzhilli e shumë mysafirë profilesh të ndryshme intelektuale. Në panair do të vijnë edhe shumë miq e dashamirë të fjalës së shkruar. Si karakteristikë e panairit të Shkupit ishte edhe pija tradicionale, "çaji i rusit" që na e binin me porosi kamerierët e çajtoreve të afërta të Bit Pazarit.

Nga e majta: Adnan Ismaili (SHB "Logos-A", Shkup), Azam Dauti (SHB "Shkupi", Shkup),dhe Qamil Rufati (SHB "Voka-4", Tetovë), para Teatrit Shqiptar në Shkup

Autori i librit dhe Abdylmexhit Saliu (SHB "ASR", Tetovë) në stendat e SHB "Shkupi", në Panairin e librit "Shkupi 2002"

Në çaj do ta ftoj Apostol Dukën nga Shqipëria. Atij i duket dukuri interesante shprehia e pirjes së çajit, madje si pije tradicionale. Ai në shaka do të thotë se në Shqipëria çaji përdoret vetëm si ilaç, kur u bie gripi, kurse për pije përdoren kafeja, alkooli dhe lëngjet tjera. Por, duke dashur të bëjmë edhe pak humor, do t'ia kthej me të njëjtën mënyrë, por anasjelltas: Te ne alkoolin e përdorin njerëzit e sëmurë kur u hip temperatura, sidomos kur është i sëmurë ndonjë fëmijë, për t'ia lyer trupin. Megjithatë, Apostolit i pëlqen çaji: "Me të vërtet qenka i mirë, ia vlejka të përdoret".

Në panair takoj dhe redaktorin e ShB "Uegen", Xhevahir Lleshin dhe e pyes se ku është i vendosur. Në hotelin "Kalabria", më tregon ai. Meqë isha me veturë, i

thashë se mund ta afroj deri te ai hotel, megjithëse nuk e dija se ku ndodhet, edhe pse si e pashë pastaj, ai kishte qenë fare afër rrugës ku jetoj unë. Kishte qenë në lagjen e Çairit, më ngushëllon për këtë mosdije se ku gjendet hoteli me faktin se ne që jetojmë në qytet nuk mund t'i dijmë hotelet sepse nuk kemi nevojë për të fjetur në to.

Duke u njoftuar me ekipin e një TV satelitor nga Shqipëria, ai do të fillojë një rrëfim interesant në lidhje me Lekën e Madh, i cili është nga nëna ilire e babai helen, e që me plotë përgjegjësi mund të thuhet se ka prejardhje edhe shqiptare por dhe greke, porse assesi maqedonasit e sotëm ta kenë prejardhjen prej tij. Është për t'u habitur si disa qarqe maqedonase pretendojnë të jenë pasardhësit e tij, kur dihet se gjërat janë shumë të pastra dhe të thjeshta, dhe kjo shihet në kujtesën historike: djali i Lekës e ka pasur emrin Piro, i cili emër në Shqipëri është mjaftë i shpeshtë. Jo kot ky emër është trashëguar brez pas brezi nëpër shekuj, deri në ditët e sodit. Kjo gjë nuk mund të thuhet edhe për maqedonasit, të cilët emrin e djalit të Lekës fare nuk e përdorin, por ndalen vetëm te Leka(Aleksandri). Pokështu, s'është e rastit që edhe monedha e Shqipërisë është pagëzuar me emrin e Leksës së Madh.

Panairi i librit mbaroi me një sukses shumë të madh e në të cilin ka pasur më shumë se 50000 vizitorë, ku janë shitur ose dhënë gratis afro pesëdhjetë mijë libra, që ndoshta për 50 vite nuk kanë shkuar te lexuesit sa për pesë ditë të panairit. Duhet veçuar edhe një rekord – abetarja e Artur Shkurtit, "Udha e shkronjave", një botim luksoz dhe me kaseta me këngë të shkronjave dhe me fletore pune, u shit në rreth 1000 kopje. Artur Shkurti nuk ktheu asnjë komplet. Përkundër çmimit të lartë (50 DM), ky botim do të shitej edhe më sikur të kishte pasë kopje tjera.

PANAIRI I LIBRIT "PRISHTINA 2002"

Pas këtij të Shkupit, e ka radhën tjetri - PANAIRI I LIBRIT PRISHTINA 2002, për ku pjesëmarrjen e vet e kanë paralajmëruar shtëpitë botuese nga Maqedonia "Shkupi", "Vatra", "Asdreni", "Çabej", "Luma", "Furkan ISM", "Logos-A", "Asr", "Idriz Seferi", e "NuN".

Nisemi të organizuar në kolonë të veturave. Shumë shpejtë arritëm në pikën kufitare të Bllacës ku kalojmë pa vështirësi. Në Prishtinë arritëm për rreth një orë, e atje na presin organizatorët, të cilët tashmë i kanë shënuar e caktuar vendet të ndara e të emëruara veç e veç për secilin botues.

Ky panair mbahet te Pallati i Rinisë dhe Sporteve, që na paraqiste problem sa i përket bartjes së librave, sepse vendi ku do mbahet është lartë e nuk kishte mundësi që të bëhej afrimi i veturave afër hyrjes në lokalin e përmendur po disi do të gjejmë mënyrë, me mundim pak, por ia dalim.

Dhe tjetër problem ishte vendosja jonë, sepse ishte vështirë të gjeje hotel që i përgjigjet xhepit tonë si librarë.

Mirëpo ne do ta zgjidhim këtë problem me shkuarjen tonë në konviktin studentor, ku disa studentë me të cilët kishim lidhje familjare, do të na siguronin fjetjen jo vetëm për natën e parë, por dhe gjatë ditëve sa zgjat panairi.

Panairin do ta hapë vetë kryetari i Kosovës, Ibrahim Rugova, një personalitet i cili para se të hynte në politikë, kishte qenë njëri nga studiuesit më të shquar të letërsisë.

Krahas tij do të gjendet edhe kryeministri Bajram Rexhepi dhe të gjithë funksionarët më lartë të jetës kulturore, politike e arsimore nga të gjitha trojet shqiptare.

Djathtas: Presidenti i Kosovës Dr.Ibrahim Rugova para stendës së SHB "Shkupi"

Në hapje të Panairit morën pjesë: Hashim Thaçi, Nazmi Rrahmani, Ali Podrimja, Rexhep Qosja, Ismail Kadare, Bexhet Brajshori, Fatmir Toçi, Azam Dauti e shumë mysafirë të kulturës e artit në përgjithësi e intelektualë të shumtë nga vendi e bota.

Kjo ishte hapja më madhështore mbas luftës që ndodhi në vitin 2001 në Maqedoni. Mandej, si është zakon, kryetari i botuesve të Kosovës, Nazmi Rrahmani do ta shoqërojë delegacionin qeveritar në krye me Bajram Rexhepin. Te stenda jonë ata shprehën interesimin e vet për situatën e shqiptarëve, e mandej edhe për veprimtarinë botuese të kësaj shtëpie botuese. Ngjashëm si kryeministri, do të veprojnë edhe të tjerët, por episodi më interesantë është me Hashim Thaçin, i cili do të interesohet për disa libra që ishin në stendën e ShB "ASR".

Hashim Thaçi
(kryetar i PDK-së me disa udhëheqës të UÇK-së)
para stendës së SHB "Shkupi"

Më kujtohen titujt e librave që i zgjodhi me këtë rast - "Rasti Izrael", dhe "Komploti Botëror" e me këtë rast përfaqësuesi i kësaj shtëpie botuese, Abdylmexhit Saliu, nuk deshi t'i marrë paratë, porse shoqëruesi me këmbëngulje do ta kërkojë llogarinë për pagesë dhe e paguan shumën e duhur. Me këtë rast do të kuptojmë se nga politikanët kosovarë, më së shumti libra lexon pikërisht zotëri Hashim Thaçi. Edhe ministri i Sportit dhe Kulturës në Qeverinë e Kosovës, Bexhet Brajshori, interesohet për veprimtarinë botuese e problemet që e përcjellin procesin e botimit të librit.

Me përfundimin e ditës së parë me kolegët tjerë, Sevim Ahmetin e me Abdylmexhit Saliun, do të ulemi në një restorant të darkojmë, e poashtu me një qëllim të përcjellim ndeshjen finale Kupës së kampionëve të UEFA-së, midis Realit të Madriti dhe Bajerit të Leverkuzeni. Duke e kryer ne darkën, fillon ndeshja mes dy ekipeve më të mira që i kishin pas eliminuar ekipet tjera evropiane. Komentatori, duke dashur që ta përshkruajë atmosferën sa më autentike, shpreh edhe dëshirën e tij që një ditë të organizohet një spektakël i vërtet sportiv edhe ndër shqiptarët. Loja ishte e barabartë, me shumë raste për shënim, por më shumë fat ka "klubi mbretëror", pra ai i Realit, falë gjeniut e mjeshtrit të futbollit Zinedin Zidan, fudbollistit francez me prejardhje algjeriane. Me këtë fitore klubi mbretëror e fiton edhe një titull, të nëntin a të dhjetin, s'më kujtohet saktësisht, por që mban këtë rekord të pakapshëm për skuadrat tjera evropiane. Duke u kënaqur nga loja e paharrueshme që e pamë, ne nisemi drejt konviktit studentor, duke dashur të bëjmë pak humor, ne themi se studentët kur të na shohin do të mendojnë se ne shkojmë në vizitë fëmijëve tanë në konvikt. Sepse, njëri nga nesh, tashmë është thinjur, tjetrit i kanë rënë flokët, kurse të gjithë bashkë i kemi kaluar të dyzetat. Por, megjithatë, për ne që kishim studiuar dikur në fakultete, të kujtojmë edhe një herë jetën studentore. Posa ramë të flemë, të parin e ze gjumi Mexhitin, i cili sa u shtri, nisi të gërhasë, edhe pse nuk është duhanxhi.

Në mëngjes zgjohemi dhe nisemi drejt panairit. Por, meqë nuk priten vizitorë aq herët, ne do të ndalemi në një byrektore për të ngrënë mëngjesin e mandej shkojmë ke librat. Në stendën time e takoj një njeri me emrin Petrit Palokaj, i cili më tregon se e njeh mirë Daut Dautin, për të cilin thotë se është gazetar i mirë por si prozator është i dobët.

Edhe shkrimtari i njohur Ismail Kadare,
duke dhënë intervistë para stendës së SHB "Shkupi"

E dëgjova me vëmendje e duke ia bërë me dije se janë dy persona me emër e mbiemër identik, njëri shkupjan dhe një tjetër prishitinas, ai zbrapset pak nga fjalët që i tha më parë dhe me librin "A vdes ëndrra" të Daut Dautit, kur e lexoi biografinë, menjëherë e pa se kishte menduar për Dautin tjetër, e jo për autorin e këtij libri me poezi.

Në Prishtinë do të takoj shumë miq të njohur nga Maqedonia që punonin dhe jetonin atje. Njëri ndër ata ishte Nuhi Vinca, i cili në erdhi në shoqëri me Berat Luzhën, një veteran i luftës, që ishte edhe deputet në parlamentin e Kosovës. Përse me emrin "Shkupi", pyet Berat Luzha, dhe unë i them se një nga arsyet për këtë ka qenë rrezikimi i toponimisë shqiptare në Maqedoni, prandaj ne vendosëm ta emërojmë ShB "Shkupi". Mandej do t'i takoj në panair

Sulejman Lokajn, Agim Vincën, Sali Ramadanin e shumë të tjerë. Sulejman Lokajn e mbaja mend qëkur jetonte e punonte në Teatrin e Kombësive në Shkup, një figurë markante të kulturës, si njeri e si aktor që kishte luajtur shumë role, si në drama poashtu edhe në filma, e ishte dëshmuar edhe si regjisor që punonte me të rinjtë entuziastë. Bashkë me artistët e mëdhenj Mark Marku, Zija Berisha, Muharem Shahiqi, Medi Bajraktari e Qemal Ajdini, ishin ata që e bënë të njohur Teatrin Shqiptar që mandej do ta vazhdojnë shumë gjenerata të reja deri në ditët e sodit. Ai thotë se në Shkup i kishte kaluar vitet më të lumtura të jetës dhe se kurrë s'do ta harrojë këtë qytet. Shkupin nuk e ndërroj me as një qytet tjetër në botë, thotë. Duke u interesuar për shumë miq që kishte në Shkup, në stendë e vëren librin për Qemal Skenderin dhe NDSH-n në Derven. Ai na uron që kemi botuar këtë libër, sepse thotë se Qemal Skënderi ishte një njeri i madh e patriot me vizionin që kishte për kauzën shqiptare edhe pse tërë jetën punoi berber në dyqan. Sulejman Lokaj u largua nga Shkupi jo pse ai deshi po për shkak të një periudhe të egër që ushtrohej nga pushteti i atëhershëm komunist.

"Kur u largova, mbeta më shpresë se një ditë do të kthehem prapë" shpreh keqardhjen e tij që s'e ka përmbushur ende këtë premtim ndaj vetvetes.

Po në Prishtinë e takoj e aktorin e regjisorin Adem Mikullovcin, i cili është njëri nga deputetët e parlamentit të shpërndarë Kosovar në kohën e Millosheviqit, që pat marrë disa vendime largpamëse historike. Do të ndërlidhet me situatën aktuale, duke na lëvduar ne shqiptarëve të Maqedonisë ditëm të përcaktohemi për njerëzit që i bën ndryshimet ndryshe nga kosovarët: "Ne në Kosovë nuk ditëm ta bëjmë këtë gjë, dhe votuam ata që e zhagitën kauzën tonë e u interesuan vetëm për pushtet".

Në Prishtinë, siç përmenda më parë, do të ekspozojmë edhe revistën dyjavore "Globi", e cila i kishte përcjellë me përkushtim ngjarjet e vitit 2001, që nga dalja e UÇK-së në skenë, me intervista të komandantëve të saj, si luftëtarë të lirisë, që luftuan edhe në Kosovë, por dhe në Preshevë e Bujanoc, më parë. Në Panair rastësisht do të vijë edhe vëllai i një luftëtari që kishte luftuar në Tanushë, emrin e të cilit e gjeti në "Globi". Është ky Muhamet Çeta, i cili njësoj si i vëllau që kishte rënë në luftë, ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe tash merret me botime. Ai është autor i disa librave që i kushtohen UÇK-së, e si më mbresëlënës është një kapitull i mbuluar edhe me fotografi, që i kushtohet thyerjes së kufirit shqiptaro-shqiptar (Kosovë-Shqipëri) gjatë vitit 1999.

Nga e majta: Autori i monografië, Abdylmexhit Saliu (ASR, Tetovë), Hajrullah Misini (Komandant Shpati) dhe Azam Dauti ("Shkupi", Shkup)

Në Panairin e Prishtinës, është shumë interesant fakti se si vizitorë të stendave, ishin shumica e deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Ata, si politikanë të rinj, më së tepërmi e kërkonin një libër të shkruar para më se 40 vjetësh, "Çka është diplomacia dhe politika" nga autori kroat A.Krizman të shtëpisë botuese "Çabej" nga Tetova.

Me të përfunduar orari i panairit, me Avdilmexhitin dhe Sevimin dalim në qytet te përmendorja e Skënderbeut, përballë Teatrit Kombëtar. Vetvetiu në bisedë e shtrojmë pyetjen a thua edhe në Shkup do ta shohim shtatoren e kryetrimit shqiptar. Kolegu Mexhiti rri i qetë dhe fare nuk ndërlidhet në bisedë, ndërsa Sevimi shpreson se vërtet do të vijë Skënderbeu një ditë, si në Tiranë e Prishtinë, edhe në Shkup. Por, vetëm nëse jemi në një qëndrim dhe me një qëllim të përbashkët, e mandej, duke kaluar afër kinemasë ABC, në repertor është filmi shqiptar "Tirana, viti Zero" dhe ne dëshirojmë të hyjmë për ta shikuar, por në ato çaste Sevimi don të kryejë një punë të vogël me një shok nga Prishtina. Duke pritur që të mblidhemi bashkë, hyjmë në një restorant në qendër, në të cilin transmetohet ndeshja e basketbollit midis "Prishtinës" dhe "Dukagjinit", dy skuadrave tepër të rivalizuara, që zgjonte kureshtje të veçantë. "Prishtina" kishte humbur ndeshjen e parë në Pejë dhe ky ishte një revansh, që prishtinasit dëshironin t'i gëzonin tifozët e tyre. Në palestrën sportive, në radhët e para të tribunave vëreheshin politikanët kosovarë, Ibrahim Rugova, Bajram Rexhepi, Agim Çeku, Hashim Thaçi si dhe vetë kryeadministratori i Kosovës, Mihael Shtajner. Ne, si shikues të rastit, që fare nuk na interesonte rezultati i këtyre skuadrave, na dukej interesant që pas çdo shënimi të pikëve, reagonin tifozët e tyre me duartrokitje dhe brohoritje frenetike. Rezultati do të jetë i paqartë deri në

fund, dhe Prishtina iu hakmor “Dukagjinit, pas çka, gjithë qyteti do të festojë deri pas mesnate. Nga kjo mund të konstatojmë se basketbolli ishte shumë i popullarizuar, por me këtë dëshmohet se gjendja ishte stabilizuar dhe ngadalë traumat që kishin përjetuar gjatë luftës kishin nisur t’i shërojnë. Në ditën e parafundit ne bëjmë një plan që të shkojmë ta vizitojmë muzeun historik të familjes Jashari në Prekaz. Kur mbaroi Panairi ne patjetër duhej të konsultoheshim me Abdylmexhitin se a jemi në ato fjalë që të shkojmë në Prekaz, por për çudi Abdylmexhiti e kishte mbushur veturën edhe më shumë me libra dhe na tregon se vetura është e rënduar shumë dhe se nuk e din se “ndoshta rruga nuk është e mirë” dhe se mendon se mund të bëhet ndonjë dëm rrugës. Pra, me fjalët e tij edhe na dështoi plani dhe u nisëm drejt për në Shkup.

PANAIRI I LIBRIT
NË MITROVICË

(29 – 30 maj 2002)

I vjen radha edhe Mitrovicës. Panairi i librit atje organizohet në kuadër të javës kulturore "Mitrovica 2002". Vendi: Shtëpia e Kulturës "Rexhep Mitrovica", afër lumit Ibër, më saktësisht, te ura ku në mënyrë të dhunshme është ndarë qyteti në dy pjesë, shqiptare dhe serbe. Në mes tyre - trupat paqësore që e kontrollojnë situatën.

Para nisjes u konsultova me botuesit shqiptarë nga Maqedonia, por asnjëri nuk është i disponuar për pjesëmarrje. Kështu u detyrova të nisem i vetëm edhe nga kureshtja që së afërmi të shoh me të vërtet se si jetojnë njerëzit në Mitrovicën e ndarë.

Në solemnitet ishin shumë njerëz të jetës kulturore e politike në Mitrovicë e Kosovë, drejtori i shtëpisë së kulturës zot. Halit Berani, përndryshe i njohur në opinionin më të gjerë si dëshmitari më i suksesshëm në procesin gjyqësor në Hagë kundër Slobodan Millosheviqit. Ai është i njohur edhe si piktor e artist në Mitrovicë, një njeri i zellshëm për inicimin e shumë aktiviteteve kulturore.

Halit Berani bëri një njoftim të shkurtër me shtëpitë botuese, duke vërejtur se nga Maqedonia merr pjesë vetëm shtëpia jonë botuese. Atij i interesoi pse nuk kanë ardhur botuesit tjerë, kurse unë si kundërpërgjigje i them se shkaku për këtë qëndron se paska pak vizitorë, që të tjerët ndoshta e kanë parashikuar këtë situatë. Nikoqiri arsyen për këtë e sheh në situatën e sigurisë që mbretëronte këtu. Ai mendon se shqiptarët duhet të dëshmohen se janë të interesuar për

librin dhe kulturën, pa marrë parasysh faktin se që të vihej te lokalet e panairit, duhet secili vizitor t'i nënshtrohet kontrollit policor të UNMIK-ut e të Kosovës duke e ditur se ata kanë një droje nga uniforma që nga sundimi i Millosheviqit. Unë do të pajtohem me konstatimet e Halit Beranit mirëpo, sikur të ishte e mundur të organizohej diku në brendinë e qytetit, ky panair i librit do të kishte më shumë vizitorë e suksesi do të kishte qenë më i madh.

Organizatori kishte siguruar vendosjen tonë në një hotel tepër luksoz me emrin "Palas". Me të vërtet shumë luksoz – dhoma të pajisura me televizorë e me banjo, me plloça cilësore, porse nëse doje, kishte dhe sauna, salla për aktivitete sportive, si tenis, golf, e bodibilding si dhe fitnes...Me një fjalë, kategoria më lart e hotelit, por dhe çmimi ishte në atë nivel.

Simboli i qytetit pa dilemë është Miniera e Stan Tërgut(Stari Tërg në kohën e komunizmit), e njohur me protestat e minatorëve në kohën kur iu mor autonomia Kosovës. Minatorët u hodhën në grevë për të mbrojtur shkallën e lartë të mëvetësisë që kishte Kosova si njësi konstituive e federatës së atëhershme. Ata kishin reaguar në mënyrë spontane kundër një fushate të egër që e kishte filluar Sllobodan Millosheviqi, mirë po atëherë në kohën e një urrejtje kolektive që ishte ndaj shqiptarëve, kishte edhe prej tyre që i kishin përkrahur shqiptarët. Edhe atëherë kishte pasur politikanë guximtarë që do të thonin se shqiptarët kanë të drejtë, si përshembull kryetari i komunistëve sllovenë, Milan Kuçan. Në Mitrovicë luftoi me hordhitë policore heroikisht trimi Tahir Meha, që dikush ia dha emrin Tahir Mitrovica, për çka mendoj se edhe e meriton për sakrificën. Këtu, tek zgafellat luftoi Femi Lladrovci, bashkë me të shoqen Xhevën, po ashtu luftoi edhe Zahir Pajaziti e shumë heronj të Kosovës e tërë

shqiptarisë. Mitrovica ka traditë të pasur edhe sportive, si në futboll, ashtu edhe basketboll. Të shpeshtën ekipet mbajnë emrin Trepça, dhe në konkurrencën e atëhershme, klubi i futbollit pat arritur në finalen e Kupës së Titos, siç quhej ai trofe që ndahej më 25 maj.

Por, t'i kthehemi librit - rganizatori në javën e kulturës në qytet, kishte paraparë edhe shfaqje të dramave, koncerte të ndryshme por edhe finalen e "plej ofit" në Ligën basketbollistike të Kosovës, mes Trepçës e Prishtinës, e cila luhej pikërisht atë ditë. Adhuruesit e shumtë që kishin ardhur nga Prishtina nuk i merrte salla të gjithë prandaj policia e UNMIK-ut e ajo kosovare me të vërtet kishin shumë punë, e simpatizantët Prishtinas nuk kuptonin se nuk kishte vend për të gjithë. Mitrovica ka dhënë gjithë ata sportistë të mëdhenj, siç ishin Fisnik Ademi, Xhevat Prekazi, Rafet Prekazi, Luan Prekazi e Adnan Zeqiri, të gjithë futbollistë të Trepçës.

Ndoshta është fat për Mitrovicën që minierat janë në anën shqiptare, porse banorët thonë se njëra pjesë është e pamundur të ekzistojë pa tjetrën, se në pjesën shqiptare ndodhen zgafellat e minierat e Stan Tërgut kurse në tjetrën janë fabrikat e ndërtuara por pa xehe e me xeherore kjo me të vërtet thonë vendasit është një absurd i madh.

Panairi i librit zgjati vetëm dy ditë dhe nuk mund të them se u ndamë të kënaqur.

PANAIRI I LIBRIT "FERIZAJ 2002"

(1-5 qershor 2002)

Ky panair mbahet në lokalet e restorantit të njohur "Roma", në qendër të qytetit, por për fatin tonë, po atë ditë mbahet një Karneval Fëmijësh, i cili ishte bërë tradicional. Është ky një manifestim në nivel komunal, prandaj mblidhen fëmijët e qytetit edhe të fshatrave, duke bërë një "rrëmujë" të paparë, që neve do të na shkaktojë telashe sepse duhet bartur librat në dorë ngase policia e kishte bllokuar rrugën që shkonte në drejtim të restorantit "Roma". Në hapjen solemne kishin ardhur shumë mysafirë të komunës e nga qeveria e Kosovës, ndër ta edhe ministri i kulturës. Poashtu duhet përmendur se të gjitha bibliotekat e qytetit, ishin mobilizuar për blerjen e librave, duke ardhur me listën e librave që iu duheshin e mandej do të vijnë ditën e fundit edhe t'i marrin, pa dallim prej cilës shtëpi botuese. E kjo ishte një orvatje e mirë për ne që sadopak t'i mbulojmë harxhimet tona. Organizatori kishte siguruar hotelin enkas për ne, me një çmim simbolik, prandaj nuk pati nevojë të kërkojmë ndonjë bujtinë të lirë.

Një botues nga Shqipëria, Petraq Risto, rrëfen se si ka filluar me botimin e librave: "Unë kam qenë gazetar sporti në radio dhe se fare nuk kam lidhje me politikën, por ndodhi ajo që ndodhi kur fitoi PD-ja me Sali Berishën, mua si edhe shumë të tjerë, na larguan nga puna. Mendo, mendo çka të bëj, dhe vendosa në fund t'ia filloj me botime librash, dhe bëra shtypshkronjë të vërtetë dhe ja sot merrem me libra. Një vajzë e kam gazetare në Amerikë, ne në Shqipëri nuk kemi paragjykime në aspektin fetar, se unë jam ateist,

por që duhet të jem ortodoks, e shoqen e kam të konfesionit islam, por fare nuk kemi mosmarrëveshje. Bile i festojmë të gjitha festat fetare në shenjë mirëkuptimi e mirëbesimi që është një pasuri e madhe te ne shqiptarët, për çka të tjerët na e kanë lakminë për këtë lloj tolerance".

"Koha e komunizmit" ndërlidhem në bisedën e Petraq Kristos, "ka qenë një regjim i vrazhdë dhe i parashikueshëm, sepse dikush ka mundur të dënohet me burg e të shpallet armik i popullit e i shtetit vetëm se nuk pajtohet me partinë, siç ka qenë rasti me Adem Demaçin, që mbajti 28 vjet burg për asgjë të rëndësishme, por habit fakti që Sali Berisha si demokrat veproi në të njëjtën mënyrë duke i nxjerrë nga puna gjithë kuadrot e monizmit, fare pa i respektuar aftësitë e tyre profesionale. Por Berisha më vonë ia pa sherrin vetvetes".

Panairi i Ferizajit, përkon me fillimin e kampionatit botëror në futboll, Kore-Japoni 2002 dhe gjithë vëmendja është kthyer andej. Ndoshta ky është shkaku që të bjerë shumë shpejtë interesimi për librat, sepse njerëzit nxitonin sa më shpejtë të shkojnë nëpër shtëpi e të ulen pranë televizorëve për të shikuar ndeshjet e futbollit. Por, ndoshta nga këndvështrimi sportiv dhe kishin pse - kampionati botëror filloi me një ndeshje sensacionale, me fitoren e Senegalit kundër kampionit aktual botëror Francës! Ky është një rezultat që nuk e kanë pritur as optimistët më të mëdhenj. Në të vërtetë, e tillë ishte ironia e fatit të këtij panairi – me fillimin e Kampionatit Botëror, do të shënojë fundin e kësaj ngjarje kulturore në qytetin hero të Ferizajt.

Rilindasi i fundit shqiptar Thoma Kacorri
bën hapjen solemne të Panairit të librit "Tetova 2002"

PANAIRI I LIBRIT "TETOVA 2002"

(1-5 tetor 2002)

Ky panair mbahet me një vonesë njëvjeçare, sepse ishte kriza e 2001-shit. Edhe pse vitin e kaluar qe nënshkruar Marrëveshja Kornizë e Ohrit, situata nuk mundësonte mbajtjen e një manifestimi. Këtë panair e hapi shkrimtari i njohur shqiptar, Thoma Kacori, porse me me prezencën e vet i shton namin edhe ish-kryetari i Shqipërisë, Rexhep Meidani, të cilit në Tetovë do t'i promovohet një libër.

Hapja e Panairit të librit "Tetova 2002"

Kuptohet, një panair në Tetovë, nuk mund të kalojë pa përfaqësues të jetës kulturore e politike, si dhe profesorë të dy universiteteve – Universitetit të Evropës Juglindore(UEJL) dhe Universitetit të Tetovës, si dhe mysafirë të shumtë nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora shqiptare. Përsëri vërshuan lexuesit, të cilët nëpër stendat e botuesve kërkonin libra të rinj, por dhe ndonjë më të vjetër që u mungon në bibliotekën e tyre shtëpiake. Edhe ne si shtëpi botuese kishim sjellë librat e botuar gjer tani, por dhe numrat më të vjetër të revistës "Globi", të cilët i jepnim me çmime fare simbolik, e dikujt edhe falas.

Më kujtohet rasti kur ia behu Ali Ahmeti me bashkëpunëtorë të tij, me ç'rast përfaqësuesit e Shoqatës së Botuesve Shqiptarë, kryetari Azam Dauti e të tjerë, do ta shëtisin nëpër stendat. Ata e njoftuan me problemet e

botimit të librit dhe pengesat që kishin pasur viteve të mëparshme.

Duke qenë pikërisht në stendën e SHB "Shkupi", do t'i cingërojë telefoni Agron Buxhakut, që ishte me Ahmetin, se në dalje të Shkupit policia e ka arrestuar Sadulla Durakun, ish-luftëtar i UÇK-së, i cili ishte nisur për Tetovë për të vizituar panairin e librit.

Mehmet Gëzhilli (SHB "Argeta" – Tiranë), ish presidenti i Shqipërisë Rexhep Meidani dhe kryetari i ShBSh-së Azam Dauti në panairin e librit "Tetova 2002"

Në këtë mënyrë, u dëshmua dyshimi se ligji për amnisti akoma nuk zbatohej siç ishte shkruar. Është çudi-ne çdo ditë udhëtonim për Tetovë me një veturë të paregjistruar, e askush nuk na ndalonte, ndërkaq Sadulla Durakun në të dalë prej Shkupi, policia e kishte arrestuar.

Rexhep Meidani i shoqëruar nga kryetari i LBSH-së Fatmir Toçi (djathtas) dhe Azam Dauti (kryetar i SHBSH-së) para stendës së SHB "Albas" (editori Latif Ajrullahu) në Panairin e librit "Tetova 2002"

Pas kësaj telefonate të celularit të Buxhakut, ai do ta ndryshojë disponimin, sepse duhej të bënte patjetër ndonjë intervenim që bashkëpartiaku i tij të lirohet.

Në panairin e Tetovës me të vërtet ishte atmosferë festive, kësaj ngjarje ia shton hijeshinë edhe promovimi i shumë librave të ri e me këtë rast do të përmendja një promovim shumë të rëndësishëm për kulturën e shkencën shqiptare e botërore. Është ky libri që i kushtohet nobelistit të dytë shqiptar, Ferid Muradin, për të arriturat e tij në fushën e mjekësisë nga autori Halil Zendeli.

Rexhep Meidani i shoqëruar edhe nga ambasadori i Shqipërisë në Shkup Vlladimir Prela, para stendave të "Flakës" dhe "Asdreni" (redaktorja Fatmira Çeliku, djathtas)...

Njeri i madh, padyshim, babai i të cilit është një emigrant me prejardhje nga Llakavica e Gostivarit, e që rrënjët e vet nuk i kishte harruar asnjëherë. Monografinë e ka botuar SHB "Vatra", themeluesi i së cilës, Halil Zendeli, është edhe autor i saj.

Halili me këtë libër ka larë një borxh kombëtar, por dhe lokalpatriotik – sepse vetë është nga Llakavica, prej nga kanë qenë prindërit e nobelistit Ferid Muradi. Vepra e H.Zendelit, "Nobelisti Ferid Muradi" sjell shumë dëshmi për shkuarjen në kurbet të të jatit, por dhe më shumë për jetën dhe shkollimin e nobelistit në Amerik,ë deri te të arriturat për të cilat dhe meritoi çmimin më të lartë për shkencë.



Nga e majta: Azam Dauti, Fatmir Toçi, presidenti Rexhep Meidani me botuesin Sotir Rrumbullaku nga SHB "Horizont", Tiranë, në Panairin e librit "Tetova 2002"

Autori me mjeshtri të veçantë e përshkruan rrugën e njeriut të madh që popullit tonë ia ngre namin, që do ta kuptojë e gjithë bota se edhe shqiptarët paskan njerëz me virtyte të larta. Me rastin e promovimit të librit, janë ftuar shumë mysafirë nga Shqipëria, Kosova e po ashtu edhe diplomatë të vendeve evropiane por dhe amerikanë.

Në sallën për promovime të Shtëpisë së kulturës, e cila ishte e ngushtë për t'i zënë të gjithë dashamirët e fjalës së shkruar, për monografinë folën recensentët Alush Kamberi e Daut Dauti, autori Halil Zendeli, por dhe intelektualë të tjerë nga trojet shqiptare.

Në fund, ky promovim mbaron me një koktej për mysafirët që e kishte organizuar botuesi i librit.



Historiani Dr.Vebi Bexheti ia dhuron librin e vet të fundit për Ballin Kombëtar i promovuar gjatë Panairit të librit "Tetova 2002" nga SHB "Çabej", Tetovë

Në panair takoj një ish – kolegë të shkollës së mesme, Naser Bilallin, i cili mbi njëzet vjet jeton dhe punon në Zvicër. Ka ardhur enkas për të marrë ca kopje të librit kushtuar Qemal Sëknderit, pjesëtar i NDSH-së, në të cilin përmendet edhe emri i babait të tij, Hasan Bilalli, një ndër mësuesit e parë të arsimit, por i njëjti edhe i dënuar si pjesëtar i NDSH-së në Derven të Shkupit.

Autor i librit është Ibrahim Krosi, i njohur deri tash për një serë veprash nga fusha e folklorit. Me shokun e shkollës së mesme ulemi për një kafe. Atij i vjen mirë që edhe emri i babait të tij u gjet në një libër që flet për të kaluarën, që flet për përpjekjet e idealistëve për shtet shqiptar duke flijuar rininë ose dhe jetën në kohë të turbullta.

Nga e majta: Sali Ramadani – Kërçova, ish deputet dhe i persekutuar politik, Liliana Kacorri (gruaja e Thoma Kacorrit), Thoma Kacorri, Azam Dauti dhe Xhezair Baftiu (afarist nga Tetova)

Por, unë nuk e kisha ditur se i jati ka qenë në NDSH, sepse gjersa ishim në shkollë të mesme ai asnjëherë nuk e kishte përmendur këtë fakt. Kush goxonte të tregonte se babai i tij ka qenë kundër këtij shteti, kundër këtij sistemi, për më tepër të tregonte se ka qenë i dënuar si pjesëtar i Partisë Nacional Demokratike Shqiptare (më të njohur për shkurticën NDSH).

Akademik Rexhep Qosja dhe ish-presidenti Rexhep Meidani ndër mysafirët më të rregullt të të gjitha panaireve të librit në hapësirën shqiptare

Edhe babain e tij e kisha njohur personalisht, porse se ka pasur biografi të këtillë dhe se ka qenë i dënuar, as ai vetë nuk ma kishte përmendur. Më kujtohet një gjë tjetër tejet interesante - djali i axhës së Naser Bilalit, Seladin Bilalli, si aktor në dramën Turke që luante në shumë drama e filma e kulmin e suksesit si profesionist e arrin pikërisht në dramën e autorit të njohur boshnjak, Mesha Selimoviq, "Dervishi dhe Vdekja", me të cilin rol i jepet çmimi për aktor më të mirë të vitit.

Kemal Ismaili (Logos-A, Shkup)
dhe Abdylmexhit Saliu ("ASR", Tetovë) në stendat e "Logos-A"

Ndejtëm mjaft me kolegun e dikurshëm të shkollës dhe u ndamë me shpresë që të takohemi përsëri. Naseri mori dhjetëra kopje të librit "Qemal Skënderi dhe NDSH në Derven të Shkupit", për t'ua shpërndarë shumë miqve dhe farefisëve të babait, shumë prej të cilëve edhe nuk e dinë se ai përmendet aty.

Në panair përveç librave të përmendur interesim të madh do të zgjojë edhe libri i autorit çam nga Tirana, Arben Kondi, me një titull mjaftë karakteristik e shumë emocional - "Çamëria Plaga që Pikon Gjak".

Autori në mënyrë shumë prekëse i ofron lexuesit një libër që flet aktualitetin e një problemi të patejkaluar në Ballkan, çështjen e çamëve të dëbuar nga tokat e veta shekullore. Shumë shqiptarë nga ajo trevë u asimiluan ose u larguan edhe pse me siguri që ka shumë prej tyre mbetën të jetojnë e punojnë atje si Aristidh Kola e shumë të tjerë. Lexuesit shprehën interesim të madh për librin, për çka dëshmon fakti se autori i shiti të gjitha kopjet që kishte sjellë nga Tirana.

Panairi i Tetovës është njëri nga më të vizituarit, prej viti në vit. Prandaj dhe pjesëmarrja e botuesve në të përherë është masovike.

Kryeministri Fatos Nano me suitën e tij
para stendës së ShB "Shkupi" në Tiranë

PANAIRI I LIBRIT "TIRANA 2002"

Për në panairin e Tiranës nisemi përfaqësues të disa shtëpi botuese me veturën Mexhit Selimin, pronar i ShB "ASR" nga Tetova. Me ne vjen edhe një mik i tij, cili e kishte të shoqen nga Tiran. Ishte rast i mirë që të vinte edhe ai, që ndonjëherë ta ndërrojë Mexhitin për vozitje.

Nga përvojata e klauara në kufi u thamë doganierëve se librat që i dërgojmë atje nuk kthehen në Maqedoni, për çka ata përherë kanë pasur mirëkuptim. Kalojmë kufirin dhe nxitojmë të arrijmë në Tiranë para hapjes solemne. Por këtë

nuk na e mundësuan kushtet e rrugës, sepse në shumë vende ishte në ndërtim e sipër. Dëshira jonë nuk do të plotësohet, sepse kur ne arritëm, panairi i librit tashmë ishte hapur. Në panairin e Tiranës si pjesëmarrës nga Maqedonia janë disa shtëpi botuese "Vatra", "Logos-A", "Nun", "Asr", "Shkupi" si dhe Biblioteka e Tetovës. Mexhiti është i brengosur se a do të gjejmë ndonjë hotel për fjetje, porse unë i them se do ta shkojmë te miku ku kisha qenë herën e kaluar, Isa. Dhe ashtu edhe ndodhi - te z.Isa shkojmë mjaft vonë, pas orës 22, i cili na bëri vend në banesën e tij.

Vizita personalitetesh

Panairin e librit ditën e dytë do ta vizitojnë edhe shumë vizitorë të shumtë. Ndër të parët e viziton edhe kryeministri shqiptar Fatos Nano, bashkë me të shoqen Xhoana. Vjen edhe në stendën tonë dhe ndalet disa minuta. Ai shpreh interesim për veprimtarinë botuese por dhe për gjendjen e shqiptarëve në Maqedoni. Ai bën dhe shaka duke më pyetur se do t'i shënojmë bashkë Ditët e Naimit. Fjalët që i dëgjova ishin mjaft domethënëse dhe në ndarje i dhurova një libër, si shenjë kujdesi për vizitën e tij stendës sonë.

Po të njëjtën ditë në vizitë arrin edhe kryetari i Shqipërisë Alfred Moisiu. Edhe ai pyeti për shumë gjëra që na përkasin neve si shqiptarë në Maqedoni.

Vizita e liderit të opozitës shqiptare, Sali Berisha, më shumë do t'i ngjaje një parade politike. Ai nuk ka kohë të ndalet nëpër stenda dhe t'i pyesë të gjithë botuesit, sepse është më i preokupuar me rrëzimin e qeverisë së Fatos Nanos.

Fatos Nano para stendës së ShB "Asr" në panairin e Tiranës

Në dallim prej tij shkrimtari i madh që jeton e vepron në Paris, Ismail Kadare, do të qëndrojë pak më shumë nëpër stenda. Vjen dhe te ne, për të shprehur interesim sidomos për botimin e veprave të autorëve shqiptarë nga Maqedonia. Ai thotë se ka shumë miq nga Maqedonia prandaj edhe shprehu dëshirën që ta vizitojë sa më parë Maqedoninë e pas vitit 2001.

Një takim shumë interesant ishte edhe ai me aktorin e madh Reshat Arbana, i njohur me rolin e tij shumë karakteristik e autentik të heroit kombëtar shqiptar Isa Boletini në filmin artistik e historik për Ismail Qemalin. Të gjithëve na kujtohet skena me ngritjen e flamurit në Vlorën historike, me atë puthjen me shumë afsh të flamurit kombëtar shqiptar, pas arritjes së vet nga Kosova, por dhe i

pikëlluar që në atë shtet nuk janë të përfshira të gjitha trojet tjera shqiptare.

Unë isha tepër i emocionuar që m'u dha rasti ta njoh Reshat Arbanën. Fitova përshtypjen se ai poashtu kishte një respekt jashtëzakonisht të madh për shqiptarët në Maqedoni e për luftën e drejt të tyre për barazi e drejtësi. Ai më thotë: "Ju na e treguat se si duhet vepruar me unitet, e për një qëllim e për kauzën shqiptare"

Mua s'më mbeti gjë tjetër pos që në shenjë respekti artistit të madh t'i dhuroj disa libra të cilët do t'i zgjidhte ai. Dhe i zgjodhi veprat "Me shipëtarët e Ukrainës"(të Daut Dauti dhe Sefer Musliut) dhe "Me arbëreshët" (autor: Rexhep Zllatku), por të cilët nuk donte t'i marrë pa nënshkrimin e botuesit. Kjo ishte gjëja më e vogël që mund të bëja për aktorin.

Më kujtohet një njeri i cili në stendën tonë u ndal duke e shfletuar librin e Ibrahim Krosit me titull "Qemal Skenderi dhe NDSH në Derven të Shkupit". Ai do të vonohet aq shumë saqë fitova përshtypjen se e lexoi në tërësi. Ky lexues i pasionuar do të vijë ditën e nesërme me lekët në dorë për ta marrë librin dhe nis rrëfimin e vet interesant. "Erdha ta marr librin ngase në të përmendet edhe im vëlla, i cili ka qenë i dënuar me shokët e vet në Shkup. Pas gjykimit të tij, ne u detyruam të shpërngulemi në Shqipëri".

Kur e kthej "shiritin" prapa, kuptoj që dje ai nuk kishte pasur lekët me vete, por meqë rrëfimi i tij m'u duk interesant, unë atë libër ia dhuroj. Për këtë gjest, ai ma kthen me blerjen e tre titujve të tjerë. Mandej e vazhdon rrëfimin për të vëllain i cili ishte gjallë por në moshë të shtyrë dhe shëndetlig por që me siguri, do të gëzohet kur ta merr në dorë librin në të cilin përmendet kontributi i tij kundër regjimit komunist në ish-Jugosllavi.

Autori i librit me Abdylmexhit Saliun
duke u kthyer nga Panairi i librit "Tirana 2002"
në Qafën e Krrabës

Ato ligje nuk ekzistojnë më, sepse nuk ekziston më as ajo krijesë artificiale e quajtur Jugosllavi, ku shqiptarët i kishin lënë pa dëshirën e tyre.

Në ditët tjera më kujtohet një dialog mes Mexhitit dhe nikoqirit të shtëpisë në lidhje me besimin fetar, kur në mënyrë naive Mexhiti mundohet të bindë Isain që ai të shkojë në xhami, e të mësohet të përshëndetet me selam alejkum. Pokështu u përpoq ta bindë atë që të agjërojë Ramazanin, por kjo shkaktonte një lloj nervozizmi te Isai. Unë do ta ndërpres atë dialog që u bë i mundimshëm, duke e ndërruar temën e bisedës që t'i jap mundësi Isait të dalë prej dhomës, ndërkohë që të kem mundësi t'ia bëj me dije Mexhitit se ajo temë këtu është e pa nevojshme, sepse Isai e

ka të shoqen katolike, dhe kjo është temë tepër e ndjeshme për të. I them Mexhitit se në Shqipëri i ke të rralla familjet ku nuk ke përzierje feshë në martesë. Mirëpo, kisha përshtypjen se Mexhiti e kishte vështirë ta kuptojë këtë realitet, e aq më tepër të bëjë dallimin midis kombëtares dhe fetares, e aq më tepër të kuptojë se ato nuk janë në kundërshtim të njëra tjetrës.

Në ditët tjera panairin e librit, e vizituan edhe shumë njerëz tjerë, si Rexhep Qosja, Ali Podrimja, Miço Samara, Dhimitër Shuteriqi e shumë njerëz të jetës politike e kulturore. Ishte rast i mirë për njoftim e për të dhuruar ndonjë libër që njëkohësisht mundësonte afirmimin e autorëve nga Maqedonia. Si zakonisht ditën e fundit i liroja librat me një çmim shumë simbolik që ishte rast i mirë për lexuesit e Tiranës me xhep të cekët, t'i blenin librat që s'kanë mundur ditëve të mëparshme. Dhe s'ke si të mos e bësh këtë, kur e di se lexuesi nga Shqipëria ka shije dhe e meriton një kujdes të tillë.

Me përfundimin e panairit, nisemi për Shkup, por për çudi, nis edhe një mot i lig me reshje bore e shiu të përshkuara me mjegull. Duhej një vozitje tepër e kujdesshme, sidomos nga Qafa e Kërrabës. Rruga Kombëtare nëpër shpatijet malore, të përkujton fjalët e akademik Rexhep Qosjes se kufiri përreth tërë Shqipërisë është malor e jashtë saj kemi tokë pjellore, e fusha, që është bërë jashtë dëshirës së shqiptarëve për caktimin e kufirit, në Ballkan.

Kuptohet se ne do ta shfrytëzojmë rastin që t'i bëjmë disa fotografi në këtë pjesë të maleve, dhe të ndalemi në disa pika të rrugës për një këndellje të vogël. Përgjatë rrugës vende vende ka pika shitëse ku mund të blesh ullinj dhe vaj ulliri, fiq, portokaj, "molla"(hurme) Japonie, mjaltë,

djathë e shumë gjëra tjera ushqimore. Për turistët kjo është një kënaqësi në vete sepse ke mundësi të zgjedhësh.

Arrijmë te dogana diku në mbrëmje, doganierit nga ana e Shqipërisë fare nuk i intereson se sa mall kemi mirëpo në anën maqedonase ata insistojnë ta kontrollojnë bagazhin, por unë fare s'e kam ditur se kolegu im ka më shumë libra se kur hymë në Shqipëri. Doganieri e kishte mbajtur mend se librat do të mbesin atje e Mexhiti fare nuk e kishte menduar se me atë veprimin e vet mund t'i shkaktojë telashe vetes por edhe mua, pasi kisha dhënë premtimin se librat nuk i kthejmë prapë. Mirëpo mbas një vonese të shkurtër, doganieri tregohet tolerant dhe na lejon të kalojmë. Pasi hyjmë në territorin e Maqedonisë, e qortoj pak kolegun, i cili nuk ua var veshin fort fjalëve të mia, sepse është i lumtur që kishte marrë shumë libra për të shitur, e të cilët nuk ia konfiskuan në kufi.

PANAIRI I LIBRIT "SHKUPI 2003"

(24-29 prill 2003)

Çka do të thotë për një panair nëse dështon në ndonjë segment organizativ? Për "Shkupin 2003" duhet folur pikërisht nga prizmi i një dështimi. Sepse, nuk u përsërit masoviteti i vitit të kaluar, kur qenë ndarë të kënaqur të gjithë pjesëmarrësit...

Edhe sivjet mbahet në të njëjtin vend - në Teatrin Shqiptar në Bit Pazarin e njohur që nga koha osmane. Në panair marrin pjesë vetëm botues nga Shqipëria dhe Maqedonia, ndërkaq edhe pse të ftuar, nga Kosova nuk erdhën.

Nga e majta:
Autori i librit, Enver Beqiri (ShB "Çabej", Tetovë),
Qamil Rufati (ShB "Voka-4", Tetovë),
Azam Dauti (ShB "Shkupi", Shkup),
Hasan Lekaj (ShB "Camaj - Pipaj", Shkodër),
Faik Selimi (ShB "Interdiskont", Shkup)
dhe Nevzat Zeqiri (ShB "Çabej", Tetovë)

Për shkak të formaliteteve doganore, botuesit kosovarë i kishin kthyer në kufi, që për Shoqatën e Botuesve Shqiptarë, ishte një goditje e rëndë, sepse dukshëm u varfërua oferta e librave. Në hapjen solemne marrin pjesë shumë mysafirë e dashamirë të fjalës së shkruar. Kjo është hera e dytë e mbajtjes së panairit në Shkup, dhe qëllimi është të bëhet tradicional. Mirëpo, në të njëjtën kohë, mbahet në Shkup edhe Panairi i Librografikës e të kompjuterëve e pajisje tjera për grafikën që do të thotë, për do gjëra edhe më i pasur e më interesant për vizitorët.



Nga e majta:
Azam Dauti (ShB "Shkupi", Shkup),Besim Dauti (drejtor në kompaninë "Dauti-Komerc", Shkup), Shaip Ziberi nga fshati Bojanë, Rahim Dauti (ShB "Shkupi", Shkup), dhe Abedin Krosi(pedagog shumëvjeçar në rrethinën e Shkupit), në stendat e ShB "Shkupi"

Përveç kësaj, në këtë manifestim që mbahet paksa më larg lagjeve shqiptare, kanë vajtur edhe disa botues shqiptarë, që çdo mungesë e tyre ndjehet në panairin që mbahet në Bit Pazar. Ky është një nga shkaqet kryesore të dështimit. Kur t'i shtojmë kësaj edhe pakujdesinë me caktimin e terminit afër një feste shtetërore, kur edhe nxënësit e shkollave mendonin për të bërë pushim disa ditësh, atëherë është e qartë pse të gjithë u ndanë të dëshpëruar.

Prandaj, mbetet që të kihet më shumë kujdes për vitet e ardhme, sidomos të mos organizohen dy panaire në të

njëjtën kohë, se fundi fundit nuk mund t'u urdhërohet botuesve se në cilin duhet të marrin pjesë, në atë ndërkombëtar, që mbahet me vite, apo në këtë mbarëshqiptar, që ka filluar prej para një viti. Për botuesit që erdhën nga Shqipëria e patën shpenzime më të mëdha ishte më rëndë që ta përballojnë faktin se nuk arritën t'i mbulojnë harxhimet për pjesëmarrjen në panair.

Por, sido që të jetë nga mediumet u përcoll me kujdesin më të madh, porse as mediat nuk mund t'i sillnin panairit më tepër blerës. Nuk duhet të habit fakti i reagimit emotiv të editorit të SHB "Eugen", i cili kishte sjellë shumë vepra të autorëve më të njohur të letërsisë botërore e shqiptare, por nuk kishte kush t'i blejë.

Ismail Kadareja i shoqëruar nga Ministri i kulturës së Kosovës, Behxhet Brajshorin

PANAIRI I LIBRIT "PRISHTINA 2003"

(16 – 21 maj)

Ky panair në kryeqendrën e Kosovës mbahet te i njëjti vend te salla e sporteve "Ramiz Sadiku", në hapjen solemne të panairit marrin pjesë shumë mysafirë si dhe funksionarë të lartë kosovarë, e me pjesëmarrjen e vet këtë manifestim do madhështojë edhe pjesëmarrja e artistëve të njohur shqiptarë, si të Çun Lajçit e Safete Rugovës, duke recituar vargje nga poeti i madh shqiptar At Gjergj Fishta e të përcjellë me muzikë nga artistë të njohur të muzikës serioze kosovare.

Edhe në këtë panair takojmë personalitete të shquara që i dhanë kontribut emancipimit kombëtar. Padyshim njëri ndër ata është edhe Dom Lush Gjergji i cili erdhi në panair. Kur kuptoi se jemi botues nga vendlindja e Nënë Terezes, Dom Lush Gjergji shprehu ngazëllimin e tij, madje duke na dhuruar nga një libër kushtuar humanistes së madhe me titull "Nënë e Madhe e Botës" që e shkruante tërë historikun e saj kësaj që nga ditët e para në Shkup e deri te shkuarja e saj në Kalkutë të Indisë, prej ku do të ngritet në një misionare të pashoqe të humanizmit, me çka dhe bota diti ta çmojë sakrificën e saj për të varfërit dhe të pastrehtët, duke ia dhënë më 1979 çmimin Nobël.

Mandej e takoj edhe një autor tjetër me vepër kushtuar humanistes nga Shkupi. Prej tij kuptojmë se e lidhin shumë kujtime me Shkupin, ku kishte kryer shërbimin ushtarak në ish-Armatën e Jugosllavisë(APJ)dhe ku kishte shumë shokë e miq që nga ajo kohë. Quhet Gjon Gjergjaj nga Klina, anëtar i grupit letrar po nga i njëjti qytet me emrin "Vorea Ujko", por dhe e piktor. Në kohën e Millosheviqit kishte qenë i diferencuar e i përjashtuar nga puna e i përndjekur nga policia, porse përkundër kësaj, do ta vazhdojë aktivitetin e vet për pavarësinë e Kosovës, pa marrë parasysh pasojat.

Në panairin e Prishtinës më së shumti kërkoheshin lektura shkollore, libra universitarë por edhe libra me përmbajtje fetare që nga Maqedonia ishin disa shtëpi botuese të specializuara për literaturë fetare islame ("Furkan-ISM", "ASR", "NuN", "Logos-A", "Neraida" e disa të tjera). Vlen të përmendet se Kurani i përkthyer e i përshtatur në shqip jepej gratis. Kur jemi te literatura fetare, nuk bën pa përmendur një shoqatë e shtëpi botuese që e shpërndante Biblën dhe libra të tjerë për Jezu Krishtin. Ishte

një vepër me titullin "Lufta Mes Zotit e Djallit", përmbajtjen e të cilit supozoja se është interesante.

Lexuesit ishin të kënaqur me ofertën e madhe në atë det librash, por kishte dhe literaturë që kërkohej, e nuk kishte sa duhet – si përshembull ajo nga shkencat teknike, për komunikacion e lidhje , elektro si dhe literaturë për sport e muzikë si dhe drama nga autorë botërorë. Sa u përket fjalorëve, ata kërkoheshin me të madhe si dhe libra për fillestarë të kompjuterëve, por dhe për bletari, një veprimtari që ka perspektivë në Kosovë.

Panairi i librit mbaroi ditën e diel nga ora dy. Para se të nisemi për Shkup, ndalemi pak për të blerë ndonjë peshqesh për fëmijët. E tregu është afër dhe ka për të zgjedhur lloj - lloj teshash. Por, përcaktohem për fanella sportive me emblemën e reprezentacioneve që zunë vendet e para në kampionatin botëror të futbollit që vitin e kaluar u mbajt në Kore e Japoni, pra, të Brazilit, Gjermanisë dhe Turqisë.

PANAIRI I LIBRIT "TETOVA 2003"

Panair i cili me plotë kuptimin e fjalës e meriton epitetin tradicional, është ai i Tetovës. Mbahet edhe sivjet në të njëjtin vend - te Pallati i Kulturës. Tetova, që tashmë është me dy universitete, e me mijëra studentë nga shumë qytete të Maqedonisë por tash edhe nga Kosova e Shqipëria, këtë festival të librit e bëjnë edhe më të vlefshëm. Interesante është se librat më të kërkuar janë fjalori Shqip-Maqedonisht, lektura të shumta shkollore por edhe libra për amvise(për gatesa), që mund lirisht të thuhet një ndër librat që më së shumti kërkohej krahas Fjalorit të Antonimeve nga autori nga Shqipëria Miço Samara. Nga stenda jonë vazhdojnë t'i kërkojnë si edhe viteve të kaluara

librat “Me Arbëreshët”, “Shqiptarët e Ukrainës” edhe një libër i autorit Agim Vinca me titullin karakteristik “Shqiptarët mes mitit e realitetit” por edhe librin e Bujar Hoxhës “Nyjet në gjuhën shqipe e angleze”.

Edhe këtij panairi, nuk i munguan botuesit dhe qindra tituj ofertë, por as interesimi i lexuesve. Tetova, Prishtina dhe Tirana, janë tri panairet ku nuk ka dështim.



PANAIRI I PËRBASHKËT
ME SHTËPITË BOTUESE MAQEDONE

Ky panair i përbashkët mbahet në Bibliotekën Universitare e shtetërore "Kliment Ohridski" në Shkup, njëra nga bibliotekat më me shumë fonde librash në Ballkan. Prandaj mbajtja në këtë bibliotekë ka rëndësi të veçantë e në hapjen solemne të saj do të marrin pjesë shumë poetë, shkrimtarë e dashamirë të artit të të shkruarit, e do të organizohet edhe ekspozita të piktorëve të njohur shqiptarë dhe maqedonas. Në hapjen solemne marrin pjesë dy kryetarët e shoqatave botuese, i asaj maqedonase Lupço Llazarevski dhe i asaj shqiptare, nga Azam Dauti, duke shpresuar se ky hap do të jetë pikënisja e organizimeve të panaireve të përbashkëta nga dy shoqatat e përmendura. Panairin e shpalli të hapur shkrimtari i njohur maqedonas, Paskal Gileski, kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve në Maqedoni. Gilevski tha se ky është një hap drejt njohjes së dy kulturave e të afrimit e afirmimit të tyre me anë të librit. Ky panair dallohet nga të tjerët se në të nuk marrin pjesë botues nga Shqipëria e Kosova por vetëm botuesit nga Maqedonia. Siç është zakon, në panair vjen edhe kryetari i Republikës së Maqedonisë, Boris Trajkovski i cili u përshëndet me një respekt të veçantë e duke u interesuar për veprimtarin tonë. Ai me të vërtet e tregoi atë spontanitetin e vet, që qëllimi i tij ishte paqe e mirëkuptimi mes popujve të ndryshëm pa marr parasysh dallimet mes kulturave e besimit të ndryshëm e bindjeve të ndryshme, i cili gjatë konfliktit që ndodhi në vitin 2001, u tregua mjaft i kujdesshëm e tolerant. Ai sipas funksionit ishte komandant

i forcave të armatosura që mund të shpallte gjendje lufte por ai nuk e bëri këtë, me çka i dha mundësi paqes e mirëkuptimit e jo luftës që çon drejt shkatërrimit, e humbjeve të mëdha në njerëz e pasuri materiale.

Në përgjithësi në panairin e përbashkët të librit ka mundësi të njohësh shumë njerëz e botues që me botimet e veta mjaft interesante zgjojnë kureshtjen. Një titull mjaft provokativ ishte "Amerika, shpëtimtar ose satana" ("Amerika spasitel ili Satana"). Për shqiptarët nuk duhet të ketë dilemë, kurse të tjerët le ta vlerësojnë si të duan. Mund të gjendet edhe libri "Vargje satanike", të autorit shumë të përfolur, e nga disa regjime arabe dhe i dënuar në mungesë, Salman Ruzhdi.

Të ulur në kafe, dy kryetarët e shtëpive botuese, Lupço Llazarevski dhe Azam Dauti do t'i përmendin ato gjëra e probleme që i preokupojnë të gjithë botuesit. Ata thonë se nuk u intereson politika, por vetëm si të përmirësohen kushtet e botimit, avancimi i librit si të modernizohet procesi grafik e ngjashëm e se sa fitohet prej librit, e dinë edhe zogjtë e malit se nga libri nuk mund të pasurohesh por vetëm të ekzistosh. Do të na kujtohen ditët studentore të kaluara po në atë bufe. Vërtet, ditë të lumtura rinore.

Ky panair, i cili si mesazh e kishte bashkëpunimin midis botuesve maqedonas dhe shqiptarë, ndoshta do të dojë kohë për t'u bërë tradicional. Por, me rëndësi është se u hodh hapi i parë, pas shumë mosmarrëveshjesh të kaluara. Vetëm duhet të vazhdohet kështu e si shenjë fillestare ishte edhe interesimi që mbretëronte për fjalorin Shqip-Maqedonisht, që me të vërtet e kishte në numër mjaft të kufizuar. Pra, panairi i paqes e mirëkuptimit e tolerancës mes dy komuniteteve më të mëdha u mbajt me mjaftë sukses e i përcjellë nga mediumet me korrektësi e pa dozë të dyshimit e me prapavijë të caktuar.

PANAIRI I LIBRIT "SHKUPI 2004"

(21-25 prill 2004)

Përsëri dështim?

Mbahet në teatrin shqiptar në Bit Pazar, por dhe ky, si vitin e kaluar, paralelisht me manifestimin ndërkombëtar "Panairi i librit e i Librografikës", ku marrin pjesë botues nga të gjitha vendet e Ballkanit, duke e përfshirë këtu edhe ata Shqipërisë! Jehona e dobët e panairit "tonë" flet se ai është dashur të mbahet ose përpara ose pas këtij panairi ndërkombëtar. Pra, termini po të ishte i shkëputur mjaft prej panairit tjetër, që botuesit të mund të merrnin pjesë edhe te njëri edhe te tjetri, por as te lexuesit të mos kishte ndonjë huti se ku të shkonin më parë.

Fazli Veliu (Kryetar i ShVL të UÇK – së)
e bën hapjen e Panairit të librit "Shkupi 2004"

Mirëpo, sido që të jetë, ai mbahet pa probleme e shënohet si ngjarje e kulturës që shumë mjete të informimit të raportojnë e të bëjnë emisione.

Si rast të veçantë do ta përmendi një botues maqedonas që do të merr pjesë në panair me botimet e veta.

Mirëpo, ai do të largohet për shkak të një ekscesi që e shkaktuan disa fëmijë (besoj se dikush i kishte nxitur!) duke e kërcënuar atë.

Ai vërtet kishte disa botime fetare të një rryme fetare jo aq të njohur por nuk ishte e lejueshme, që dikush t'i kërcënohet mysafirit të ftuar që e paguan stendën shitëse si të gjithë të tjerët.

Nxënësit kumanovarë në Panairin e librit në Shkup

Vërtet dikush nuk e kupton domethënien e fjalës "tolerancë", sepse nuk vlen toleranca vetëm kur atë e kërkon nga të tjerët për pikëpamjet tua, por dhe të qëndrimit tënd ndaj të tjerëve.

Duhet thënë se edhe disa shtëpi botuese shqiptare nga Maqedonia dhe Shqipëria kishin shkuar në Panairin e Librografikës, si "Toena", "Uegen", "Vatra" e "Logos-A". Nga ana tjetër, vlen të përmendet si pozitive pjesëmarrja në "Shkupi 2004" e një botuesi, "Asdreni" me në krye shkrimtarin e saj, Azem Zogajn që e begatoi manifestimin. Me fondin e vet të pasur të librave që kishte ai zgjoi mjaft interesim te lexuesit.

U bënë disa promovime të librave, si ai i Nehat Sadikut me titull "Turbulenca politike", që do të zgjojë mjaft interesim te lexuesit, sepse libri i përfshin ngjarjet që

ndodhën vitet e fundit duke hedhur një dritë të re mbi ngjarjet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, si dhe në rajonin e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës. Ky libër u botua nga SHB "Shkupi".

Në panairin e Shkupit do të mungojë një organizim më i mirë i shkollave fillore e të mesme. Të kishin treguar të paktën një respekt ndaj botuesve nga Shqipëria e Kosova. Kësaj radhe munguan edhe bibliotekat, të cilat viteve të mëparshme vinin dhe blenin në shumicë, duke ardhur madje edhe nga qytetet tjera.

Mbetet dilema se si do t'i bindim botuesit nga Shqipëria në vitet e ardhshme, nëse kalojnë shumë keq si sivjet.

Sepse, pa këta botues, të cilët kanë botimet më të larmishme, oferta e panaireve nuk ka kuptim fare.

Darka e botuesve në Teatrin Shqiptar në Shkup

PANAIRI I LIBRIT "PRISHTINA 2004"

(24 – 28 maj)

Ky është panairi i gjashtë me radhë pas çlirimit të Kosovës nga regjimi serb. Për nga organizimi me të vërtet mund të thuhet lirisht se është më përmbajtësori – ku ka dhe recitime të aktorëve, përcjellje të vargjeve me muzikë që i japin një bukuri të vërtetë manifestimit në fjalë.

Ditën e parë, te botuesi nga Maqedonia erdhi njëri nga më të merituarit për organizimin e luftës në Kosovë, njëherësh edhe ndër pjesëmarrësit në konferencën historike të Rambujesë, Ramë Buja, i cili me një respekt të madh

përshëndetet me ne dhe duket shumë i interesuar për situatën në Maqedoni. Në shenjë respekti ia dhuroj një libër, por ai nuk don ta marrë pa nënshkrim, që nuk ishte ndonjë problem për mua si përfaqësues i "Shkupit". Ishte një kënaqësi që ia dhurova një libër pikërisht njeriut që e mori rrugën drejt luftës për çlirimin e Kosovës. Por edhe ai do të bëjë një gjest simbolik të respektit - ma dhuron një stilolaps për kujtim. Rrëfen për luftën dhe nuk lë pa përmendur se në ndihmë na kanë ardhur edhe luftëtarët nga Maqedonia duke i përmendur Ali Ahmetin, Gëzim Ostrenin e Ismet Jasharin-Kumanova e Mujdin Aliun. Të fundit dhe ranë ranë dëshmorë në tokën kosovare.

Duke treguar se Marrëveshjen e Rambujesë të cilën e nënshkroi pala shqiptare, ndërkaq e refuzoi ajo serbe, ai tha se serbët as që kishin menduar për nënshkrim të saj por vetëm të fitojnë në kohë për t'u përgatitur për luftë me ne shqiptarët. Mirëpo ka një gjë shumë të vërtetë se me atë akt mashtrimi që serbët mendonin t'ua bënin ndërkombëtarëve, ata vetë ranë në grackë. I zbuluan qëllimet e veta të mbrapshta, bota pa se shqiptarët janë faktorë konstruktivë, dhe e identifikoi burimin e problemeve - diktatori Millosheviq me politikën e tij fashizoide, i cili më vonë edhe do të përgjigjet për akte kundër njerëzimit për shkatërrim në masë e njerëz me qëllim të pastrimit etnik të shqiptarëve nga trojet e veta shekullore. Falë luftës, me ndihmën e NATO-s e SHBA-ve shqiptarët ia arritën qëllimit që ta largojmë okupatorin nga Kosova.

Mbas largimit të mysafirit, vazhdon biseda në temën se si të veprohet me shpërndarjen e një gazete nga Maqedonia në Kosovë. Mirëpo Sadri Husmani tashmë e bënte një gjë të tillë, sepse edhe e distribuonte gazetën e vet "Super Argëtuesin".

Gjatë panaireve kishte shumë botues që praktikonin dhënien produksionit të tyre botues falas, kështu bënte edhe ShB "Asr", duke dhuruar revistën "Dituria"

Ai tregon se me të vërtet ka shumë më shumë shitje në Kosovë mirëpo është një problem i mbledhjes parave nga tirazhi, sepse asnjëherë nuk ke mundësi që sa herë të bësh orvatje për një gjë del ndonjë pengesë që edhe shkakton probleme atëherë kur ke nevojë më së shumti.

Në panair do t'i takoj dy ish - bashkëfshatarët e mi që kishin ardhur të vizitonin panairin dhe për të parë se a kishte editor nga Maqedonia. Janë këta Rexhep Mazllami, e Mensur Naipi, që të dy të lidhur me aranzhmane biznesi në

Kosovë, i pari me ndërmarrjen e kushërinjve të mi, "Dauti komerc", ndërkaq i dyti është përfaqësues për disa firma maqedonase për Kosovë. Unë jam nga Bojana, por i shpërngulur që para 32 vjetësh, kurse ata dy ende jetojnë atje. Ky ishte për mua një rast i mirë të pimë një kafe me ta dhe për të biseduar për shumë gjëra e probleme e zhvillim në tërësi, bashkë me shokët e përmendur, të cilëve u interesonte literature për informatikë ose ndonjë doracak për fillestarë të kompjuterëve që edhe kërkoheshin më së shumti në panair. Duke i shëtitur nëpër stenda më pyesin mos di ndonjë libër që unë do t'ua preferoja. Pa dilemë u thashë të blejnë veprën e mikeshës së shqiptarëve, Edit Durham, "Ngatërresa ballkanike" 1 dhe 2.

Në panairin e librit ka edhe libra të dedikuar besimtarëve të tri konfesioneve, Islame, Katolike, Ortodokse. Kurani i përkthyer në shqip si herëve të kaluara, shpërndahet gratis. Kurse te stenda e Lidhjes së Protestantëve në Kosovë, mund të blehet Bibla e përkthyer në shqip, por dhe shumë libra tjerë të ekspozuar.

Duhet cekur se Prishtina vlen për një mjedis ku nuk përzihen punët, e ku shkenca është shkencë, letërsia letërsi, e feja fe. Në dallim nga Shkupi, ku shumë njerëz, madje dhe intelektualë, gjerat ngaherë i shikojnë nën dioptrinë e ngushtë të paragjykimeve dhe nuk mund të kuptojnë se përcaktimi fetar është e drejtë private e individit.

Librin që më së shumti e kërkonin te stenda jonë, është "E folmja e shqiptarëve të Ukrainës". Kjo ngase një profesor i Katedrës së Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe në UP, studentëve të vet ua ka sugjeruar këtë libër që të njihen me një të folme shumë të afërt me "gjuhën e Skënderbeut".

Në panair takoj dhe një njeri nga Derveni, i shpërngulur në Kosovë për shkaqe politike. Ai erdhi te stenda jonë që të marrë librin kushtuar Qemal Skënderit dhe NDSH-së në Derven të Shkupit, por u nda i dëshpëruar kur i thashë se ai tashmë është grabitur nga lexuesit. Ai ishte inxhinier i makinerisë dhe kishte shumë njohuri të mëdha në drejtimin e teknikës dhe se unë e kisha të ngjashëm profesionin, e komunikacionit rrugor e që kishim mjaft tema interesante për të biseduar për atë kohë sa ndejti te stenda.

PANAIRI I LIBRIT "PRIZRENI 2004"

(6-8 qershor 2004)

Panairi i librit mbahet në kuadër të manifestimit "Java kulturore e Prizrenit" e cila parasheh shumë koncerte muzikore, prezantim të grupeve kulturore – artistike, shfaqje të grupeve amatore e profesionale. Pra, për ta pasuruar këtë manifestim, do të jetë edhe Panairi i librit, ku marrin pjesë shtëpi botuese nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia ("Furkan-ISM" dhe "Shkupi"). Në dallim nga panairet tjera, ky mbahet nën qiell të hapur, para lokaleve të muzeut kombëtar "LIDHJA E PRIZRENIT". Edhe një specifikë tjetër-orari i tij ishte nga orët e pasditës, deri në orët e vona të mbrëmjes, sepse vizitorët vinin pikërisht në këto orë, ngase ditën bënte vapë e madhe.

Prizreni është një qytet historik e me arkitekturë të vjetër. Këtu është kështjella, prej së cilës ka një shikim të veçantë dhe qyteti shihet si në pëllëmbë të dorës. Bien në sy shumë xhami, e shtëpi të vogla e të ulëta por të mbajtura mirë. Sa u përket ndërtesave të larta, ato lirisht mund të numërohen në gishtat e dy duarve. Ndër monumentet e shumta, do të zë vend edhe shtatorja e Ismet Jasharit – Komandant Kumanovës, dëshmor i UÇK-së. Ai erdhi të luftojë për tokën e shtrenjtë shqiptare duke e prishur rehatinë e një punëtori në perëndim ku bënte një jetë normale. Ai e prishi rehatinë me t'iu dhënë mundësia që të luftojë kundër okupatorit serb, duke flijuar dhe jetën. U flijua, por u bë i pavdekshëm.

Në Prizren vendasit e konsiderojnë veten si qytetarë të vërtetë me një kulturë specifike. Bie fjala, kur takohen dy qytetarë prizrenas, përshëndetjen e fillojnë në gjuhën turke, kurse mandej vazhdojnë shqip, por gjithë kohën duke i përzier fjalët nga të dy gjuhët. Duket se kjo është një vetëdije e trashëguar se për të qenë "qytetar i vjetër", duhet të flasësh turqisht! Kjo, thotë një mik, është një e folme "e lazdruar" por që në anën tjetër forcon bindjen se në Prizren ka lënë gjurmë sundimi i osmanlinjve, më shumë se gjithkund tjetër në Kosovë.

Gjatë panairit kishte shumë vizitorë nga të gjitha trojet shqiptare. Një zonje i bën përshtypje libri i autorit shkupjan Jetulla Curri me titullin "Kolltuku sa i mirë është". Në të vërtetë, asaj i kishte bërë përshtypje mbiemri Curri, duke më pyetur mos është autori nga familja e saj, sepse zonja tregon se është stërmbesa e heroit kombëtar, Bajram Curri. Kur i tregova se autori është nga Shkupi, ajo tha se nuk ka gjasa që të ishte ndonjë lidhje farefisnore ndonëse gjyshi i saj kishte luftuar e bile edhe arritur që me çetën e tij ta çlirojë Shkupin, i cili atëherë ishte qendër e vilajetit të

Kosovës. Është kënaqësi e vërtetë biseda me një zonjë të emancipuar e intelektualisht të ngritur dhe me origjinë nga një familje që dha flijesa për kombin. Megjithatë, e merr librin e Jetulla Currit, për të cilin jam shumë i sigurt se nuk do ta përmbushë kurreshtjen e saj, por dhe vepra të tjera nga shtëpia jonë botuese. Largohet e gëzuar që takoi një banor të qytetit për çlirimin e të cilit kishte luftuar stërgjyshi i saj i famshëm.

Kur shëtit nëpër qytet, të bie në sy lumi por dhe e fontana të shumta, me ujin e ftoftë që rrallë e gjen diku tjetër. Këtu janë edhe qebaptoret, kafeteritë e restorantet e shumta.

Panairi mbaroi dhe për ne ishte edhe një pasuri e njohje me veçoritë karakteristike të qytetit historik shqiptar.

PANAIRI I LIBRIT "STRUGA 2004"

(23-25 korrik 2004)

Me plot kuptimin e fjalës ngjarje e madhe kulturore për qytetin e bukur të Strugës. Ky manifestim kulturor mbahet në të njëjtin vend ku do të mbahet edhe festivali tradicional muzikor "Këngë Jeho 2004". Për shkaqe sigurie që të dy manifestimet mbahen në një vend të mbyllur e jo si herëve tjera te stadiumi i qytetit, ky vend, ishte shtëpia e kulturës në Strugë edhe një gjë e rëndësishme është se ishin do protesta të organizuara, kundër ligjit për organizimin e ri territorial, me ndarjen e re të komunave të propozuara

nga qeveria e Maqedonisë të cilin duhej ta miratojë parlamenti. Atmosfera ishte acaruar tejmase, por për hir të këtyre manifestimeve, organizatorët do t'i ndërprejnë "në shenjë tolerance ndaj qytetarëve shqiptarë", edhe pse nuk mund të fshihet qëllimi këtyre protestave që ishin pikërisht kundër interesave të tyre. Panairin e librit do ta shpallë hapur kryetari i SHBSH-së, Muhamet Murtezi, kurse të pranishëm ishin shumë njerëz të jetës politike në qytetin e Strugës por dhe nga mbarë Maqedonia, ndër ta edhe akademikët Ali Aliu dhe Luan Starova, por dhe shumë qytetarë e turistë që kalonin pushimet verore.

Këtu takojmë edhe historianin njohur shqiptar nga Manastiri, prof. dr. Reshat Nexhipin bashkë me gazetarin e njohur po nga i njëjti qytet, Qenan Hasanin. Me Qenan Hasanin njiheshim nga më herët, me rastin e promovimit të një librit të Adem Demaçit në teatrin Shqiptar në Shkup, por me profesorin Reshat Nexhipin ishte hera e parë, ndonëse kisha lexuar shumë shkrime nëpër shtypin shqiptar.

Struga do të lajë dhe borxhin ndaj një autori të vet – bëhet promovimi përmbledhjes së dramave të Nexhat Mustafës, "Shpëtimi nga Gollgota". Në promovimin e përmendur marrin pjesë shumë miq e familjarë por edhe njerëz të artit e kulturës, Ali Aliu, Luan Starova, Tahir Hoda, Mehmet Latifi, Fejzi Bojku por edhe ministri i arsimit, Aziz Pollozhani, i cili edhe do ta merr fjalën. "Njerëzit shtronin pyetjen se si do bëhet me qytetarët e Strugës nesër, pas protestave e shkatërrimin e disa lokaleve e pasurive shqiptare që i bën njerëzit e pa përgjegjshëm, e ne shqiptarët iu përgjigjemi me libra, me muzikë, e me promovime të librave, pra, me mençuri me tolerancë e pa dhunë e shkatërrime. Ja, pra, mendoj se përgjigjja më e mirë se promovimi i librit nuk ka".

Këtë manifestim madhështor do ta nderojnë: artisti shqiptar, po nga ky qytet, Xhevat Limani, me leximin e fragmenteve nga libri i Nexhat Mustafës, si dhe dy muzikantët e njohur të muzikës serioze Sihana Badivuku e Blerim Grubi, që interpretuan pika muzikore.

Panairi e arsyetoi vetëveten, sepse u bë hapi i parë me shpresë të bëhet tradicional, në të ardhmen do t'i shkonte më tepër të mbahej në qiell të hapur, ndoshta para Pallatit të Kulturës ose madje përgjatë rrugës së çarshisë, sepse është sezoni i pushimeve e turistëve vetëm kështu mund t'ua tërheqësh vëmendjen.

PANAIRI I LIBRIT "GJILANI 2004"

Ftesa për pjesëmarrje në këtë panair na arrin me vonesë të madhe, një ditë para hapjes së panairit, megjithatë do të nisemi dy shtëpi botuese nga Maqedonia, "Shkupi" dhe "Vatra". Nisemi tepër të gëzuar ngase tri ditë para arritjes, atje reprezentacioni i Shqipërisë kishte mundur atë të Greqisë me rezultat 2:1. Me të vërtet kjo është një mburrje për çdo shqiptar, sepse është mundur kampioni evropian nga Portugalia 2004. Me këtë rezultat të shkëlqyer ajo për një çast do ta kthejë vëmendjen se edhe reprezentacioni i Shqipërisë din të luajë futboll cilësor, se një ditë edhe do të vijnë rezultatet. Është hera e parë që marrim pjesë në panairin e Gjilanit që ishte tradicional. Në hapjen solemne në praninë e një numri të madh qytetarësh, para Teatrit dhe

bibliotekës së qytetit, ishin të pranishëm edhe funksionarë komunalë si dhe nga qeveria e Kosovës. Ndër ta ishte edhe Kurtesh Saliu profesor universiteti por edhe autor i librit "Autonomia dhe rrënjët e saj" që në kohën e Millosheviqit u cilësua si libër që i jep legjitimitet ndarjes së saj nga Serbia e Jugosllavia. Me një fjalë shpallet si libër që e afirmon separatizmin shqiptar që më vonë edhe do të ndodhë jo nga ai libër, por si rezultat i politikës fashizoide të regjimit millosheviqian. Në hapjen e panairit, organizatori e shoqëron elitën e ftuar të funksionarëve të lartë me në krye Kurtesh Saliun, që ishte poashtu nga ky qytet, i cili për nga madhësia është i dyti apo i treti në Kosovë.

Në panair takoj këngëtarin e njohur të po këtij qyteti, Demir Krasniqin, i cili ishte profesor i muzikës në gjimnazin e qytetit, i cili u tregua mjaft mikpritës dhe do të më ftojë edhe në kafe e bisedë për shumë gjëra interesante për probleme e halle që i ndjekin shqiptarët kudo që janë, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni apo Mal të Zi. Demir Krasniqi ishte i interesuar të botojë në Maqedoni një libër me këngë folklorike nga repertori i gjerë i tij, në SHB "Shkupi" konkretisht, por unë jam i detyruar që t'ia tregoj procedurën me të cilën ne i botojmë librat, e kuptohet për një punë serioze duhet edhe kontratë serioze për një botim të një vepre.

Të njëjtën ditë luhej ndeshja kualifikuese për kampionatin botëror Gjermania 2006, mes Gjorgjisë e Shqipërisë. Do të ishte tepër me rëndësi edhe një fitore e radhës, pas asaj me Greqinë. Unë si tifoz i kombëtares shqiptare, isha i interesuar ta përcjell ndeshjen në një restorant të qytetit dhe kuptohet se ka njerëz që fare nuk iu interesonte futbolli. Njëri ndër ta ishte Halil Zendeli botues i SHB "Vatra", të cilit i tregova se do shkoj ta shikoj ndeshjen e futbollit dhe e luta që t'm'i shikojë librat. U

dakordua, pa ditur se unë do të mungoja dy orë të plota. Por, ndeshja do të mbarojë në atë mënyrë që do na dëshpërojë, ndonëse gjatë gjithë lojës ishte reprezentacion më i mirë. U dëshmua se jo përherë nuk fiton më i forti, sepse ndonjëherë dikujt i ec fati më tepër. Por, fundja, kush të ka faj nëse nuk i shfrytëzon rastet tua për shënim, kur e ke vetë fatin e lojës në duart tuaja! Kjo ndeshje është e kaluar dhe mbesim me shpresë që herëve tjera reprezentacioni shqiptar me trajnerin gjerman, Hans Piter Brigel, të arrijë rezultate si ai me Greqinë dhe të kualifikohet në Kampionatin botëror Gjermania 2006.

Panairi ka shumë vizitorë të interesuar për libra, por dhe librarë "interesantë". Njëri syresh ishte pranë meje. Saherë që vinin njerëz te stenda e tij ku kishte libra e materiale të tjera për kompjuterë dhe informatikë, ai i përshëndette me shprehjen "Selam alejkum". Dhe nuk e lash pa e pyetur përse në vend se mirëdita ose ndonjë shprehje tjetër shqip, vazhdimisht përshëndetet arabisht. Ai më dha një përgjigje jo aq bindëse për mua: "Ajo është përshëndetje myslimane, e ne të gjithë jemi myslimanë". Jo, zotëri, i thashë, nuk jemi të gjithë myslimanë, por është e vërtetë se të gjithë këtu janë shqiptarë. Dhe unë jam shqiptar, dhe pastaj edhe myslimanë, ndërkaq ke shqiptarë që nuk janë myslimanë dhe nuk e dinë domethënien e përshëndetjes arabisht.

Ai pa menduar shumë thotë se ajo është njësoj. Jo, i them, nuk mund të jetë njësoj se unë më shumë do t'i përmbahem asaj kombëtares e mandej edhe konfesionit.

Këtë dialog e kishte përcjellë me vëmendje edhe Azem Zogaj, i cili do të ndërhyjë duke e mbajtur anën time, jo pse don të më ndihmojë mua, por pse janë qëndrime të shumicës dërmuese shqiptare. Shqiptarët nëpër shekuj kanë luftuar për komb e shtet, e asnjëherë për fe, por është e

vërtetë se fetë e ndryshme ndër shqiptarët, nuk kanë qenë pengesë për këto synime shekullore. Ç'po ndodh tash me disa koka, është për të të ardhur gjynah, sepse nuk mund të dallojnë prioritet kombëtare.

Ky ishte një panair që vërtet mua e Halilit na ka befasuar, sepse interesimi për librin ishte i madh dhe do të më ndodhë ajo që s'e kisha pritur, por që e kisha dëshiruar – t'i harxhoj të gjitha librat!



Rektori i Universitetit të Tetovës, Fadil Sulejmani e bën hapjen e Panairit të librit "Tetova 2004"

PANAIRI I LIBRIT "TETOVA 2004"

Panairin e librit e hap ish-rektori i UT-së, Fadil Sulejmani i cili e pranoi këtë gjë me kënaqësi. Në fjalën e rastit ai do nënvizojë se tubimet e tilla janë të diturisë, artit, kulturës e traditës së një kombi, për krahasim me të tjerët popuj.

Në emër të botuesve nga Shqipëria e përshëndeti Apostol Duka, kurse nga Kosova Bexhet Bici, si dhe kryetari i ShBSH në Maqedoni, Muhamed Murtezi.

Kryetari i ShBSh-ë në Maqedoni, Muhamed Murtezi mban fjalimin e tij në hapjen e Panairit të librit "Tetova 2004"

Ndër zyrtarët e lartë politikë, u gjetën ministri i Arsimit, Aziz Pollozhani dhe deputeti Husein Xhevat Huseini, i cili në Parlamentin e Maqedonisë pati një replikë të gjatë me deputetin Sashko Kedev rreth decentralizimit. Me këtë rast, deputeti shqiptar e kishte cituar shkrimtarin Sllavko Janevkin "Kur njeriu e ngre zërin, e ka vështirë të mendojë e të logjikojë" duke e pyetur pasta "E ju, zotëri Kedev, si arrini që edhe të bërtisni edhe të mendoni?"

Në panairin e Tetovës bëhet promovimi i librit të poetit e Ramadan Sinani me titull "Në Tetovë shtëpi të kesh", botim i SHB"Voka-4" (pronar Qamil Rufati), i cili merret me botimin e revistave për fëmijë si "Nxënësi" e "Xixëllonja".



Apostol Duka, nga ShB "Labova" – Tiranë, përshëndet Panairin e Librit "Tetova 2004"

Ky promovim u bë me një organizim të jashtëzakonshëm, me pika të larmishme muzikore e me recitime të aktorëve të rinjë të UT-së.

Është një njeri në Tetovë, i cili nuk lë manifestim pa e përcjellë, qofshin festivale, koncerte e tubime të ndryshme. Është ky Skënder Pasholli, i cili me fotografitë e veta pa kurrfarë kompensimi, këto ngjarje i bën të përjetshme. Prandaj edhe i shprehë publikisht falënderimin tim edhe për këtë monografi, sepse pa fotografitë e tij, gjithçka do të ishte e thatë.

Me kolegët botues, Sadri Husmanin e Faik Selimin, ulemi në një lokal pranë Pallatit të Kulturës dhe bisedojmë për shumë gjëra. Faik Selimi është editor i shtëpisë botuese "Interdiskont" përndryshe, inxhinier i elektroteknikës dhe ekspert që punoi një kohë në Elektrokosovë, por me masat e

dhunshme të Serbisë në Kosovë, edhe ai e përjetoi fatin e shumë shqiptarëve që mbetën pa punë. Tash merret me grafikë e me botimin e librave. Ai është ndër botuesit më kompletë, i cili me përkushtim dhe me seriozitet u qaset botimve ose punëve me porosi. Kështu, disenjimi dhe botimi irevistës së nxënësve të gjimnazit "Zef Lush Marku" - "Interfoni", është vepër e punës së Faikut.

Panairi i Tetovës është për nga numri i vizitorëve i treti pas Tiranës e Prishtinës, panair që mundësonte edhe shitje solide. Mirëpo, bie në sy mungesa e librave nga fusha e shkencave teknike, si dhe literature për sport e muzikë.

Me "Tetova 2004" po e përmbyll këtë monografi. Por, jeta e panaireve të librit nuk merr fund këtu. Ato vazhdojnë prej qyteti në qytet duke joshur lexuesin me ofertë titujsh e çmimesh më të volitshme. Të gjithë e gjejnë llogarinë e vet – botuesit ngase arrijnë, anise me çmime më të ulëta, të shesin tirazhe më të mëdha se në libraritë ku të shpeshtën mund të flejnë librat me muaj e vite, ndërkaq lexuesit, se librat ju vijnë te pragu, dhe me çmime më të favorshme se rëndom. Takimet mes botuesve, krijuesve, lexuesve, masiviteti i vizitorëve... të gjitha janë fenomene që i përcjellin panairet e librit, duke i bërë ato vërtet ngjarje kulturore për t'i shënuar.

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Panairi i librit "Tetova 2000"	13
Panairi i librit "Tirana 2001"	20
Vizitë muzeut kombëtar historik "Skënderbeu" në Krujë	38
Panairi i librit "Korça 2002"	51
Panairi i librit "Shkupi 2002", i pari me përmasa mbarëkombëtare	55
Panairi i librit "Prishtina 2002"	59
Panairi i librit në Mitrovicë	68
Panairi i librit "Ferizaj 2002"	71
Panairi i librit "Tetova 2002"	73
Panairi i librit "Tirana 2002"	84
Panairi i librit "Shkupi 2003"	91
Panairi i librit "Prishtina 2003"	95
Panairi i librit "Tetova 2003"	98

Panairi i përbashkët
me shtëpitë botuese maqedone 100
Panairi i librit “Shkupi 2004” 102
Panairi i librit “Prishtina 2004” 106
Panairi i librit “Prizreni 2004” 111
Panairi i librit “Struga 2004” 114
Panairi i librit “Gjilani 2004” 117
Panairi i librit “Tetova 2004” 121